

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it




E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.2-FEBBRAIO/SHKURT 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it



Përralla e Kledit

Madje "Më mirë se një përrallë". Pas filmit "Passo a due", jeta e Kledi Kadiut u jepet adhuruesve të tij tashmë në libër. Kësaj here është ai vetë që ulet të shkruajë biografinë e vet të romancuar për Mondadorin. "Meglio di una favola, i sapodale më 27 janar shfaq që tani të gjitha shenjat e një suksesi më shumë për idhullin e qindramijëra italianeve.



FLUKSET 2008 Pas paraqitjes së kërkesës

Kërkesat për punësim në kuadrin e dekretit të flukseve 2008, por edhe shumë të dekretit 2007, kalojnë nga një zyrë në tjetrën. Rrugëtimi administrativ i kërkesave, i ndjekur hap pas hapi. TAR-i i Lazios fut në garë edhe punëdhënësit e huaj me leje-qëndrim të përjashtuar fillimisht nga dekreti qeveritar i flukseve 2008.



GJOBAT

Si mund t'i kundërshtosh

Nga çasti i njoftimit të procesverbalit të gjobës, nëse i interesuari nuk mendon të paguajë gjobën, fillon të llogaritet koha brenda të cilës mund të paraqesë ankesë, pra të kundërshtojë me gjyq shkeljen që i është njoftuar.



WESTERN UNION
 MONEY TRANSFER

Vodafone One Nation New
 Gë sot vendlindja jote është më afër



NË PRITJE TË NULLA OSTA-S

Procedura e dekretit të flukseve parashikon që kërkesat e punësimit të paraqitura në favor të shtetasve të huaj jokomunitarë, duhet të shqyrtohen nga një sërë zyrash kompetente për aspekte të ndryshme të punësimit dhe të qëndrimit të të huajve në territorin italian: Kuestura, Drejtoria Provinciale e Punës (DPL), Qendra për Punësimin (CPI).

Para se punëdhënësi të thirret nga Sporteli Unik për Imigracionin për tërheqjen e nulla-osta-s është e nevojshme që kërkesa, para së gjithash, të hyjë në numrin e kuotave të parashikuara nga dekreti i flukseve dhe të marrë 'rrugë të lirë' nga të gjitha zyrat kompetente.

Në pritje të thirrjes nga Sporteli Unik është e mundur të kontrollohet në ç'pikë ka mbërritur praktika përmes shërbimit të verifikimit të ofruar nga ministria e Brendshme në website-n e saj në adresën: <http://domanda.nullaostalavoro.interno.it>.

Lo stato della pratica

Në ç'pikë mund të jetë praktika

Përmes kontrollit telematik, është e mundur të gjenden informacione të ndryshme lidhur me rrugëtimin administrativ të kërkesës për nulla-osta për punë.

Ja cili është kuptimi i çdo shprehjeje që merret si përgjigje:

Richiesta DPL

Kërkesa në DPL

Kërkesa po shqyrtohet nga Drejtoria Provinciale e Punës që kryen kontrollin mbi kontratën e punës që do t'i aplikohet të huajt që po thirret, mbi të ardhurat e punëdhënësit. Më pas DPL i jep një kuotë sipas kategorisë së punës dhe provincës.

Richiesta Questura

Kërkesa në Kuesturë

Kërkesa po shqyrtohet nga Kuestura që kontrollon nëse ndaj punonjësit të huaj që thirret ekzistojnë motive

Kërkesa në Qendrën për Punësimin

Kërkesat për punësim të paraqitura në kuadrin e dekretive të flukseve kalojnë nëpër shumë zyra. Kuestura bën kontrolle mbi punëdhënësin dhe punëmarrësin për të parë nëse këta kanë ndonjë precedent penal apo motiv pengues për lëshimin e autorizimit të punës. Drejtoria Provinciale e Punës kontrollon nëse punëdhënësi ka të ardhura të mjaftueshme për punësimin e një personi, nëse kontrata që ka deklaruar se do të lidhë me personin që thërret me flukset është e rregullt dhe nëse ka ende kuota të lira qoftë të atij profesioni qoftë të asaj province.

Veç këtyre dy zyrave, kërkesat kalojnë edhe në Qendrën për Punësimin, CPI, që ka për detyrë të verifikojë nëse ka ndonjë punonjës në Itali të gatshëm t'i përgjigjet kërkesës së paraqitur për të sjellë dikë tjetër nga jashtë Italisë.

Në veçanti Qendra për Punësimin, brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës nga Sporteli Unik, verifikon gatishmërinë e ndonjë punonjësi të mundshëm italian, evropian apo të huaj me qëndrim në Itali, për vendin e punës së ofruar. Ja se ç'mund të ngjasë:

- Qendra për Punësimin mund të mos përgjigjet brenda 20 ditëve nga marrja e kërkesës. Në këtë rast vlen parimi heshtje-miratim dhe kërkesa mund të vazhdojë rrugëtimin e saj administrativ në zyrat e tjera.

- Qendra për Punësimin përgjigjet duke dhënë një listë emrash personash të interesuar për vendin e punës. Në këtë rast procedura pezullohet deri kur punëdhënësi nuk i komunikon Sportelit Unik (dhe për njoftim edhe Qendrës për Punësimin) dëshirën e tij:

1. të vazhdojë me praktikën për të sjellë në Itali punonjësin e ri për të cilin ka paraqitur kërkesë emërore;

2. të pranojë punonjësit e sinjalizuar nga Qendra për Punësimin dhe në këtë rast Sporteli Unik mbyll praktikën e paraqitur me dekretin e flukseve.

- Qendra për Punësimin përgjigjet se nuk ka asnjë njeri të gatshëm të pranojë ofertën e punës, dhe në këtë rast punëdhënësi ka 4 ditë kohë për të njoftuar Sportelin Unik (dhe për njoftim Qendrën për Punësimin) nëse mendon të çojë përpara kërkesën për sjelljen në Itali të punonjësit të huaj apo të tërheqë kërkesën. Nëse brenda katër ditëve nuk mbërrin lajm nga Punëdhënësi, kërkesa konsiderohet e konfirmuar dhe vazhdon rrugëtimin e saj administrativ.

Në përgjithësi, nëse Qendra për Punësimin nuk përgjigjet apo nëse punëdhënësi konfirmon dëshirën për të sjellë në Itali punonjësin e huaj, kërkesa vazhdon rrugëtimin deri sa mbërrihet në nxjerrjen e autorizimit për punë dhe në kërkimin e dhënies së kodit fiskal pranë Agjencisë së të Ardhurave.

Sporteli Unik për imigracionin, më në fund, thërret punëdhënësin që ky të tërheqë autorizimin e punës dhe të firmosë Kontratën e qëndrimit. ditën e takimit, operatori i Sportelit Unik, pasi i lëshon nulla-ostën punëdhënësit, ia përcjell telematikisht nulla-ostën edhe përfundimisht diplomatike konsullore italiane në vendlindjen e punonjësit.

”

Para se punëdhënësi të thirret nga Sporteli Unik për Imigracionin për tërheqjen e nulla-osta-s është e nevojshme që kërkesa të hyjë në numrin e kuotave të parashikuara nga dekreti i flukseve dhe të marrë 'rrugë të lirë' nga Kuestura, Drejtoria Provinciale e Punës (DPL), Qendra për Punësimin (CPI).

penguese për hyrjen dhe qëndrimin e tij në territorin italian (për shembull, nëse mbi të rëndon ndonjë dekret dëbimi).

Stampa Richiesta CPI

Shpallje e kërkesës në CPI

Sporteli Unik për Imigracionin ia ka përcjellë kërkesën Qendrës për Punësimin. Praktikisht, Qendra për Punësimin, brenda 20 ditëve nga komunikimi i Sportelit Unik, verifikon disponibilitetin e punonjësve italianë, komunitarë apo jokomunitarë në

Ndërsa zaret janë hedhur që një vit më parë, kërkesat për punësim në kuadrin e dekretit të flukseve 2008, por edhe shumë të dekretit 2007, kalojnë nga një zyrë në tjetrën, në secilën prej të cilave duhet të marrin mendimin pozitiv.

Ndërkohë TAR-i i Lazios fut në garë edhe punëdhënësit e huaj me lejeqëndrim të përjashtuar fillimisht nga dekreti qeveritar i flukseve 2008.

FLUKSET 2008



Itali të interesuar për ofertën e punës që është objekt i kërkesës së nulla-ostës. Për shembull, kur një punëdhënës ka kërkuar një murator shqiptar, CPI verifikon, brenda 20 ditëve nga marrja e lajmërimit nga Sporteli Unik, nëse për këtë ofertë është i interesuar dikush tjetër që banon në Itali.

Notifica di Rigetto Questura (ex art. 10)

Lajmërim zyrtar i refuzimit nga Kuestura (ish neni 10)

Kuestura ka shprehur mendim negativ. Punëdhënësit do t'i jepet komunikim zyrtar të paralajmërimit të refuzimit të kërkesës dhe mundësia për integrimin e praktikës brenda 10 ditëve nga marrja e letres. Nëse Sporteli unik nuk do të marrë asnjë integrim, do të mbyllë praktikën duke lëshuar masën e hedhjes poshtë të saj dhe do të japë mesazhin: "Provvedimento di Rigetto Questura" (refuzuar nga Kuestura).

Notifica di Rigetto DPL (ex art. 10)

Lajmërim zyrtar i refuzimit nga DPL (ish neni 10)

Drejtoria Provinciale e Punës ka shprehur mendim negativ. Punëdhënësi do të marrë komu-

nikim zyrtar të hedhjes poshtë të kërkesës. Edhe në këtë rast, atij do t'i jepet mundësia e integrim-it, brenda 10 ditëve nga marrja e lajmërimit. Nëse brenda këtij afati, Sportelit Unik nuk i mbrin asnjë dokument integrimi, ai mbyllë përfundimisht praktikën dhe nxjerr masën e refuzimit. Në këtë pikë mesazhi është: "Provvedimento di Rigetto DPL" (refuzuar nga DPL).

Integrazione dati DPL - inoltro al richiedente

Integrim të dhënash DPL - t'i përcillet të paraqitësit të kërkesës

Në këtë rast, DPL ka kërkuar, integrimin e praktikës, të cilës i mungojnë të dhëna thelbësore. Sporteli Unik do t'i dërgojë punëdhënësit një letër me të cilën i tregon se ç' dokumente kërkohen.

Nulla Osta rilasciato e trasmesso al MAE

Autorizimi i lëshuar dhe i transmetuar Ministrisë së Jashtme

Nulla-osta telematike i është dërguar ministrisë së Punëve të Jashtme dhe pritet përgjigja paraprake për thirrjen e punëdhënësit.

vijon në faqen 4



Gjykata Administrative e Lazios hedh poshtë kufizimet për punëdhënësit e huaj

Gjykatësit: "Sipas ligjit, për punësimin mjafton leja e qëndrimit". Duhet të merren parasysh edhe kërkesat e atyre që nuk kanë konfirmuar on-line

Ajo pjesë e dekretit të flukseve 2008 që parashikon marrjen në konsideratë vetëm të kërkesave të paraqitura nga punëdhënësit e huaj me kartë qëndrimi dhe që duhet të bënin konfirmimin online është pezulluar. Për lëshimin e 150 mijë autorizimeve duhet të merren parasysh të gjitha kërkesat e paraqitura në kuadrin e dekretit të flukseve 2007, edhe ato të paraqitura nga punëdhënës me leje qëndrimi.

Kështu kanë vendosur me urdhëresën 206/09 të datës 14 janar, gjykatësit e TAR-it të Lazios, duke i dhënë të drejtë një grupi punëdhënësish të huaj të koordinuar nga patronati Inca-Cgil. Sipas gjykatësve, kufizimet e vendosura me dekret ndaj punëdhënësve të huaj shkelin ligjin mbi imigracionin, që, në këtë aspekt, barazon italianët dhe të huajt me qëndrim të rregullt në Itali, edhe nëse këta të fundit kanë vetëm lejen e qëndrimit.

Nga 15 dhjetori deri më 3 janar, periudhë që ishte lënë në dispozicion të punëdhënësve të huaj me kartë qëndrimi për të konfirmuar kërkesat e tyre të paraqitura me flukset 2007, në ministrinë e Brendshme mbërritën 127.151 konfirmime (4.148 konfirmime vetëm nga punëdhënës shqiptarë). Por ç' do të ndryshojë me urdhëresën e TAR-it të Lazio-s? "Për të lëshuar 150 mijë autorizimet e hyrjeve të dekretit 2008 qeveria duhet të marrë në konsideratë të gjitha kërkesat e paraqitura, edhe ato të punëdhënësve me leje qëndrimi e që nuk kanë bërë konfirmimin online" shpjegon Enrico Moroni i patronatit Inca. "Vendimi i gjykatës vlen për të gjithë Italianë - nënvizon Moroni - ndaj të gjithëve, punëdhënës e punëmarrës, nuk u mbetet tjetër veç të shprehësh 'të peshkohen', duke pasur parasysh se edhe këtë herë shumë do të mbeten pa kuota".

Në të vërtetë qeveria mund të paraqesë apel kundër urdhëresës së gjykatës administrative, por ka shumë pak mundësi të fitojë. Për më tepër, edhe mes teknikëve të ministrisë që përgatitën tekstin e dekretit të flukseve 2008 ka pasur që në fillim dyshime mbi kufizimet e caktuara për punëdhënësit e huaj, që u kërkuan me forcë nga ministrat Maroni e Sacconi për të kundërshtuar bashkime familjare të maskuara.

Sot mund të themi se procedura e konfirmimit gjatë periudhës festive të fundvitit ishte një humbje kohe e

vijon në faqen 4

TAR-i i Lazios hedh poshtë kufizimet për punëdhënësit e huaj

vijon nga faqja 3

kotë. Ndoshta vlejti vetëm që Maroni të dilte e të bënte deklarata të rreme nga mesi i janarit kur pohoi se "konfirmimet e mbërritura në ministri janë vetëm 127 mijë, 13 mijë më pak se kuotat e parashikuara nga dekreti" gjë që sipas tij do të thotë se "për shkak të krizës ka rënë edhe kërkesa për punonjës të huaj". Por ministri harron që 127 mijë konfirmimet janë të punëdhënësve të huaj me kartë qëndrimi, pra vetëm e një pjesë të vogël të të gjithë punëdhënësve. Në të vërtetë janë shumë, sepse këtyre u duhen shtuar edhe qindra mijëra kërkesa të punëdhënësve italianë që nuk duhet të bënin asnjë lloj konfirmimi.

Sa për rënien e kërkesave për krah pune nga jashtë, ministri harron që në këtë drejtim konfirmimet nuk tregojnë asgjë. Ky dekret fluksesh nuk merr parasysh kërkesa të paraqitura sot, por ato të një viti më parë, ndaj është e pamundur që të vlerësohet nëse ka rënë apo jo kërkesa e familjeve dhe e ekonomisë italiane për punonjës të huaj.

E shifrave të dhëna nga ministri u shkoi nga pas edhe deputetja e PdL-s Isabella Bertolini: "Ndryshe nga e majta, ne e kishim kuptuar që kriza ekonomike po çonte drejt humbjes së vendit të punës mijëra italianë e të huaj... Ishte e qartë për të gjithë që vendimi për reduktimin e kuotave të flukseve ishte absolutisht i logjikshëm dhe që mund të kundërshtohej vetëm nga të papërgjegjshmit. Sot shifrat na japin të drejtë - përfundon triumfuese ajo - dhe përgënjeshtrojnë të majtën fjalëshumë që është për dyert e hapura".

Elvio Pasca

NË PRITJE TË NULLA OSTA-S

vijon nga faqja 3



”

Nëse praktika është e bllokuar, mund të kërkohen sqarime dhe përsheptimi i praktikës në tri mënyra: i dërgohet kërkesë me shkrim drejtorit të Sportelit Unik për sqarime mbi gjendjen e praktikës; mund t'i dërgohet sportelit një "njoftim për mospërbushje të detyrës", dhe të këshillohet të zhblokojë praktikën. Nëse nuk zgjidhet gjë në këto dy mënyra, mund të paraqitet ankimi në Gjykatën Administrative të Krahinës, që do të lëshojë një sentencë që detyron Sportelin Unik të lëshojë sa më shpejt ose autorizimin ose refuzimin e kërkesës.

vijon nga faqja 3

Nulla Osta Rilasciato e Consegnabile

Autorizimi i lëshuar dhe është gati për t'u dorëzuar

Sporteli Unik i dërgon letrën e thirrjes punëdhënësit që ky të paraqitet për të marrë autorizimin e punës dhe për të firmosur kontratën e qëndrimit.

dokumentin e refuzimit apo autorizimin e punës.

Kush nuk hyn në dekretin e flukseve 2007 a mund të shprejë akoma?

Me shpalljen e dekretit 2008, që praktikisht u ka shtuar 150.000 kuota të reja, 170.000 kuotave të dekretit 2007, shumë kush mund të shprejë të përfitojë një nga kuotat e reja.

Nëse praktika është bllokuar?

Është e mundur të përsheptohet shqyrtimi i praktikës duke i dërguar një kërkesë me shkrim për këtë gjë Përgjegjësit të Sportelit Unik, me postë rekomandë me lajmërim marrjeje. Është e këshillueshme që kjo kërkesë të nisët edhe me faks pasi kërkesat e paraqitura në këtë mënyrë shqyrtohen disi më shpejt.

Nëse megjithë kërkesën e shkruar situata nuk zhblokohet, nevojitet t'i dërgohet sportelit një "diffida ad adempiere" (njoftim për mospërbushje të detyrës), edhe ky me postë rekomandë me lajmërim marrjeje, me të cilën ftohet Drejtori i Sportelit të zhblokojë praktikën dhe të shpjegojë motivet e vonësve.

Por nëse zyra nuk përgjigjet për 30 ditët e mëpasme, do të jetë e mundur të paraqitet ankesë në Gjykatën Administrative të Krahinës, TAR, për të marrë një sentencë që të detyrojë Sportelin Unik të lëshojë

Në fakt dekreti 2008 parashikon ripeshkimin e kërkesave të dekretit të vitit 2007, vetëm nëse punëdhënësi është italian apo i huaj me kartë qëndrimi. Për këta të fundit parashikohet edhe konfirmimi on line i kërkesës. Por me sentencën e TAR-it të Lazios, do të merren parasysh edhe kërkesat e punëdhënësve të huaj me lejeqëndrim, pasi gjykatësit u shprehën qartë që "sipas ligjit në fuqi, kush kërkon të punësojë dikë duhet të jetë me qëndrim të rregullt në Itali". Që do të thotë se duhet të ketë dokumentin e qëndrimit, qoftë kjo kartë apo leje. Ndaj kufizimet e vendosura nga qeveria, lidhur me domosdoshmërinë e kartës së qëndrimit, për punëdhënësit e huaj, janë të jashtëligjshme.

Teresa Olivadese
www.stranieriinitalia.it

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKZIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE Ë ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keti Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPJUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i

Bota shqiptare

gazeta e shqiptarëve në itali

ISTITUTO LUCE
PRESENTA



ALBANIA

IL PAESE DI FRONTE

REGIA
ROLAND SEJKO
MAURO BRESCIA



LUCE

**IL PRIMO DOCUMENTARIO
SULLA STORIA DELL'ALBANIA**



REGIONE LAZIO

N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E

FACSIMILE RICORSI

RICORSO ALLA PREFETTURA

PREFETTURA DI ...

Ricorso ex art. 203 C.d.S.

Ill.mo Sig. Prefetto,

il sottoscritto ..., nato a ... il ... e residente in via ... n. ... premesso che - in data ... la ... (indicare l'Autorità intervenuta), notificava al ricorrente, conducente/proprietario dell'autovettura targata ..., verbale di contestazione n. ..., per violazione dell'art. ... C.d.S. per aver " ... (descrivere la contravvenzione concretamente elevata) ...";

- tutto quanto sopra premesso, l'esponente ricorre

alla S.V. affinché, previa audizione personale dell'esponente, voglia dichiarare inefficace e/o annullare il provvedimento impugnato, e conseguentemente pronunciare ordinanza di archiviazione degli atti, per i seguenti

motivi in fatto ed in diritto

1) (esporre i motivi) 2) ... 3) ...

Si insiste pertanto, nell'accoglimento del presente ricorso.

In via subordinata

Stante le disagiate condizioni economiche del ricorrente, così come risulta da ... (es. stato di disoccupazione), quest'ultimo chiede venga disposto il pagamento rateizzato della somma dovuta a titolo di sanzione amministrativa.

Si allega copia del verbale di contestazione notificato a ...

Luogo e data ...

Con osservanza, Il ricorrente



Kodi rrugor përcakton rregullat që çdo person duhet të respektojë kur nget një mjet automobilistik.

mund të paraqitet ankesë në raste të tilla kur:

1. në procesverbal nuk është shënuar vendi, dita dhe

SI MUND T'I KUNDËRSHTOSH GJOBAT

Nga çasti i njoftimit të procesverbalit, nëse i interesuari nuk mendon të paguajë gjobën, fillon të llogaritet koha brenda të cilës mund të paraqesë ankesë, pra të kundërshtojë me gjyq shkeljen që i është njoftuar. Nëse gjyqi nuk i jep të drejtë kundërshtuesit të gjobës, këtij të fundit i mbërrin në shtëpi e ashtuquajtura kartela tatimore, mospagimi i të cilës, mund të çojë deri në sekuestrimin e të mirave materiale të shkelësit.

Ankim pranë Prefektit

Nëse zgjidhet të paraqitet ankesë, kjo duhet bërë brenda 60 ditësh nga njoftimi i procesverbalit.

Si përgatitet ankesa

- Drejtpërdrejt Prefektit me anë të një letre të dërguar me postë të porositur me lajmërim marrjeje;

ose

- zyrës apo komandës që ka lëshuar gjobën (policia bashkiake, policia rrugore) duke e dorëzuar personalisht apo duke ia dërguar me postë të porositur me lajmërim marrjeje.

Në të dyja rastet është e këshillueshme të bashkëngjiten të gjitha dokumentet që mendohet se janë të përshtatshme për të treguar që ankesa është e bazuar mbi fakte dhe të kërkohet të dilet për-



Ekzistojnë dy tipe ankesash alternative:

1. te Prefekti

2. te Gjykatësi i Paqes i vendit ku është kryer shkelja

RICORSO AL GIUDICE DI PACE

Il Giudice di Pace di,

RICORSO AI SENSI DELLA LEGGE

689/81

Il sottoscritto ..., nato il ..., a ..., residente in .., per gli effetti del presente atto, domiciliato in .. via, ecc.

PREMESSO DI AVER RICEVUTO

accertamento di violazione verbale di contestazione n. di infrazione al Codice della Strada per la presunta violazione dell'art. (indicare la violazione contestata), notificato in data .../.../... Poiché l'accertamento operato appare infondato, illegittimo e ingiustificato, il sottoscritto intende proporre ricorso alla S.V. Ill.ma contro il suddetto accertamento-contestazione sulla base dei seguenti MOTIVI (esposizione dei motivi)

Per tutti questi motivi il sottoscritto CHIEDE che la S.V. Ill.ma, riscontrate l'infondatezza e l'illegittimità dell'accertamento operato, Voglia annullare il verbale di accertamento e contestazione impugnato. CHIEDE

altresì che la S.V. Ill.ma Voglia sospendere l'esecutività del provvedimento impugnato, sussistendo sia il "fumus boni iuris" sia il "periculum in mora", e attesi la fondatezza dei motivi addotti e il grave pregiudizio che deriverebbe al ricorrente dall'esecuzione del provvedimento stesso, considerate l'enlità della sanzione pecuniaria irrogata e delle condizioni economiche del ricorrente (illustrare brevemente le proprie eventuali condizioni economiche non agiate).

Si allegano:

- n. ... copie del presente ricorso; - n. ... copie del verbale di accertamento; - ... eventuali altri documenti.

Nëse një nga këto rregulla shkelen, personeli i autorizuar (zakonisht policia bashkiake) mund të përpilojë një procesverbal, me shkeljen dhe masën e gjobës, që i jepet në dorë drejtuesit të mjetit ose, nëse kjo gjë nuk është e mundur (për shembull kur kalohet me semafor të kuq, kur makina është parkuar në një vend të ndaluar), procesverbal i dërgohet në shtëpi pronarit të automjetit (kur sillet në shtëpi, kush e tërheq vë firmën dhe, nga ky çast, për policinë procesverbal i është njoftuar të interesuarit, italisht 'notificato').

Nga çasti i njoftimit të procesverbalit, nëse i interesuari nuk mendon të paguajë gjobën, fillon të llogaritet koha brenda të cilës mund të paraqesë ankesë, pra të kundërshtojë me gjyq shkeljen që i është njoftuar.

Ekzistojnë dy tipe ankesash alternative: 1. te Prefekti; 2. te Gjykatësi i Paqes i vendit ku është kryer shkelja.

Kështu, për shembull,

ora e shkeljes;

2. nuk është shënuar emri (ose edhe vetëm numri i amzës) i agjentit që ka verifikuar shkeljen;

3. nuk është shënuar norma e shkelur.

Nëse gjoba njoftohet 150 ditë pas kryerjes së shkeljes, ajo nuk duhet të paguhet, por edhe në këtë rast duhet paraqitur kërkesë për 'heqje të masës së gjobitjes për njoftim me vonesë'.





para Prefektit për të shpjeguar më mirë arsyet e kundërshtimit të gjobës.

Prefekti, pasi shqyrton dokumentet, dëgjon të interesuarit që kanë bërë kërkesë mund të vendosë si më poshtë:

1. të hedhë poshtë ankesën dhe të lëshojë një urdhëresë të motivuar pagese me të cilën detyron shkelësin të paguajë një gjobë jo më të ulët se dyfishi i shumës minimale të parashikuar për shkeljen e kryer, si dhe shpenzimet e procesit (pagesë që duhet kryer brenda 30 ditëve nga njoftimi zyrtar).

2. të pranohet ankesën dhe të ndjekë më pas arkivimin e akteve.

Kujdes: Prefekti duhet të vendosë për një ankesë brenda 120 ditëve nga data e dërgesës së ankesës dhe urdhëresa e pagesës duhet t'i njoftohet të interesuarit brenda 150 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

Ankim pranë Gjykatësit të Paqes

Brenda 60 ditëve të parashikuara për të paraqitur ankesë para Prefektit, është e mundur që, në alternativë, të paraqitet ankesë para Gjykatësit të Paqes, dhe në këtë rast është e nevojshme prania e një avokati.

Gjykatësi i Paqes, pasi ka marrë ankesën, vendos datën e seancës për daljen në gjyq të palëve dhe urdhëron autoritetet që kanë lëshuar

gjobën që kundërshtohet të depozitohet një kopje të raportit me procesverbalet



Kartela tatimore është një dokument me të cilin një koncesionar (agjent që merret me vjeljen e kredisë) fton debitorin të paguajë shumat në para që i detyrohet entit kreditor

përkatese të verifikimit të shkeljes për të cilën është lëshuar gjoba në fjalë.

Pasi bën seancën, ku pjesëmarrja është e detyrueshme, Gjykatësi i Paqes mund të vendosë si më poshtë:

1. të pranohet ankesën dhe në këtë rast gjoba nuk duhet paguar;

2. të hedhë poshtë ankesën dhe, në këtë rast, shuma e gjobës mund të konfirmohet, të ulet ose të ngrihet (por kujdes, vetëm gjoba mund të pësojë ndryshime në shifra, jo masat e tjera administrative si për shembull pezullimi e patentës apo heqja e pikëve).

Kujdes: nëse nuk paraqitesh në seancë e nuk paguan gjobën, ose nëse ankesa hidhet poshtë shuma që duhet të jepet do të kërkohet me kartelë tatimore (cartella esattoriale). Në raste të tilla, ligji parashikon që mospagimi i gjobës të çojë deri në sekuestrimin e të mirave materiale të shkelësit, ose në bllokimin administrativ të automjetit.

www.stranieriinitalia.it

KARTELA TATIMORE

Çdo qytetari që nuk paguan rregullisht taksat (përfshirë edhe abonimin vjetor RAI, taksën e qarkullimit rrugor të automjeteve), tatimet, gjobat, mund t'i dërgohet në shtëpi e ashtuquajtura kartela tatimore (cartella esattoriale) me të cilën t'i kërkohet që t'i derdhë shtetit atë çka i detyrohet.

Kartela tatimore është një dokument me të cilin një koncesionar (agjent që merret me vjeljen e kredisë) fton debitorin të paguajë shumat në para që i detyrohet entit kreditor (Shtetit, enteve shtetërore dhe vendore, enteve të sigurimeve shoqërore).

Kartela tatimore përmban të dhënat e debitorit, të koncesionarit dhe të entit kreditor; shumën që duhet paguar, motivin e pagesës; afatin dhe mënyrat e pagesës; subjektet kujt duhet t'i drejtohen për të kërkuar anulimin e kartelës nëse e konsideron të jashtëligjshme

Ndarja me këste e pagesës
Nëse debitori, për shkak të pamundësisë ekonomike të çastit, tregon se nuk është i aftë të paguajë të gjithë shumën njëherësh brenda afatit të caktuar në kartelë, mund t'i kërkojë Agjentit të vjeljes së taksave ndarjen në këste të debisë (dhe për rrjedhojë të paguajë me këste shumën që i detyrohet entit kreditor).

Kërkesa e përpiluar në fletë të thjeshtë (pa pullë-taksë) duhet të plotësohet nga dokumentacioni i përshtatshëm për të dëshmuar vështirësitë ekonomike të çastit (për shembull, humbje e vendit të punës, krizë e aktivitetit privat) kur kërkesa pranohet, pagesa mund të ndahet në, maksimumi, 72 këste mujore, mbi të cilat do të aplikohen interese bankare.

Anulimi i kartelës tatimore
Nëse qytetari është i mendimit që shuma e shënuar në kartelë nuk është e saktë (për shembull, sepse ka paguar debinë) duhet të kundërshtojë kartelën drejtpërdrejt pranë entit kreditor (jo pranë koncesionarit, agjentit të vjeljes së taksave) duke kërkuar

apo nëse dëshiron të paguash më këste; mënyrën për të paraqitur ankim gjyqësor.

Afati i pagesës

Kur një shtetasi i mbërrin një kartelë tatimore, ka 60 ditë kohë për të paguar shumën e kërkuar; nëse paguan pas këtij afati duhet të derdhë, përveç shumës së shënuar në kartelë edhe kamatën e shpenzimeve dytësore të mundshme.

Nëse debitori nuk paguan, Agjenti i mbledhjes së taksave është i detyruar me ligj të nisë procedurën për rikuperimin e shumës përmes përmbarimit të detyrueshëm të të mirave materiale, gjë që mund të konsistojë në: ndalimin administrativ të automjeteve, hipotekë, sekuestrim të pronave të tundshme dhe të patundshme etj.

Mënyrat e pagesës


Ekzistojnë mënyra të ndryshme të pagesës së kartelës tatimore. Debia mund të paguhet pranë sporteleve më të afërta të Agjentit të mbledhjes së taksave ose në zyrat postare apo të bankave duke përdorur buletinin e bashkëngjitur kartelës tatimore.

anulimin dhe duke i bashkëngjitur kërkesës dokumentacion të përshtatshëm (për shembull, kuponin e pagesës). Zyra kompetente, pasi të ketë verifikuar pagesën, duhet të anulojë kartelën, të pezullojë procedurat e mundshme të përmbarimit të detyrueshëm dhe të lajmërojë Agjentin e vjeljes së taksave për anulimin e kartelës.

Ankesa

Kartela tatimore përmban edhe mënyrat, subjektet dhe afatin brenda të cilit mund të paraqitet ankesë gjyqësore. Ankesa kundër një kartele mund të paraqitet vetëm për mangësi apo defekte formale (për shembull debia është parashikuar, kartela është anuluar, shuma është paguar), për shkak se njoftimi zyrtar (notifica) nuk është i rregullt ose për parregullsi të njoftimit zyrtar fillestar të debisë (për shembull, kur debitori nuk ka marrë kurrë njoftim zyrtar për një gjobë për shkelje të kodit rrugor, mund të kundërshtojë kartelën tatimore duke iu drejtuar gjykatësit të Paqes ose Gjykatës tatimore).

Rosanna Caggiano
www.stranieriinitalia.it



PËRRALLA E KLEDIT

Madje "Më mirë se një përrallë". Pas filmit "Passo a due", jeta e Kledi Kadiut u jepet adhuruesve të tij tashmë në libër. Kësaj here është ai vetë që ulet të shkruajë biografinë e vet të roman-cuar për Mondadorin. "Meglio di una favola, i sapodalë më 27 janar shfaq që tani të gjitha shenjat e një suksesi më shumë për idhullin e qindramijëra italianeve.

Eka emrin Kledi simboli i shqiptarëve të mirë në Itali. Dhe historia e tij u shndërruar në një përrallë hirushi që rëndom gazetaret italianë imagjinonin pas çdo shqiptari të suksesshëm. Skema përmbante gjithë mendimet bajate që një italian i vijnë ndërmend kur përpara syve u del një shqiptar: gomonja, Shqipëria e varfër - tokë e tmerreve, dhe në fund arritja eventuale e suksesit në një vend që nuk është i veti. Edhe kjo lloj historie është shndërruar në simbol të shqiptarëve të suksesshëm së bashku me vetë Kledin personazh publik të admiruar në Itali.

Por Kledi është shumë më tepër se kaq. Për të thënë këtë dhe për të rrëfyer edhe më tepër nga jeta e tij publikut i ofrohet më së fundi edhe një autobiografi e tij, botuar nga

shtëpia botuese Mondadori. Libri titullohet "Meglio di una favola" dhe nuk mund të kishte titull më të përshtatshëm, që të sintetizonte suksesin e Kledit, dhe tejkalimin e pritmërive me të cilat ai zbarkoi në bregun tjetër të Adriatikut shumë vite më parë që sot duken shekuj të lënë pas nga ritmet e ndryshimit të gjithçkaje për Kledin dhe për shqiptarët.

Ai ishte një balerin, një nga më premtuesit e Teatrit të Operas dhe të Baletit të Tiranës që mori rrugën me një valixhe ëndrrash për arsye shumë më logjike e me këmbë në tokë se sa rëndom përshkruhen. Tirana kishte një shkollë të mirë baleti, një balet cilësor, por që siç ndodh shpesh në Shqipëri ngurronte të përditësohej e të kapte trenin e simotrave nëpër skenat po aq cilësore të botës. Dhe për

"Meglio di una favola" sepse Kledi i atëhershëm nuk mund të mendonte se një ditë jeta e tij do të shndërrohej në një film, e më pas në libër dhe se djaloshi shqiptar do të listohej në krye të personazheve më të dashura të rinisë italiane. Këto janë të gjitha gjëra që Kledi, balerin nga teatri i Operas së Tiranës nuk kishte si t'i imagjinonte.

një balerin premtues mbyllja në një skemë klasike të mbe-tur pas, kohërave të shkuara të zhvillimit artistik, shndër-rohet në një tundim të papër-ballueshëm për tu larguar e për të mbërritur ato prurje të reja që rastësisht shfaqeshin në ndonjë cep të programacionit të televizioneve italiane që ishin aq të ndjekura në Shqipërinë e asaj kohe. Kështu ajo që motivoi nisjen e djaloshtit shqiptar në ato vite të turbullta për gjithë shqiptarët ishte ambicia për tu përmirësuar profesionalisht që më pas Italia ia dha me bujari duke mos u kursyer madje për shumë më tepër se kaq.

"Meglio di una favola" sepse Kledi i atëhershëm nuk mund të mendonte se një ditë jeta e tij do të shndërrohej në një film, e më pas në

vijon në faqen 10



Vodafone One Nation New

Që sot, vendlindja jote është më afër.

**Një tarifë e vetme për Italinë dhe për vendin tënd.
15 qindarka në minutë përgjithmonë.**

Aktivizo falas Vodafone One Nation New dhe do të kesh 1000 minuta në muaj për të komunikuar me vendlindjen tënde duke paguar përgjithmonë vetëm 15 qindarka. Për informacione mbi planin dhe vendet në të cilat aplikohet kjo tarifë, lutemi të vizitoni faqen e internetit www.vodafone.it

Tarifë paguhet përpara 60 sekondave të parë të telefonatës dhe ka vlerën 15 qindarka. Shuma e paguar në momentin e përgjigjes është 16 qindarka.

Life is now



KLEDI KADIU

Meglio di una favola

vijon nga faqja 8

libër dhe se djaloshi shqiptar do të listohej në krye të personazheve më të dashura të rinisë italiane. Këto janë të gjitha gjëra që Kledi, balerin nga teatri i Operas së Tiranës nuk kishte si t'i imagjinonte. Në një farë mënyre ndodhi që ai të zhytej kokë e këmbë në atë ëndërr që ishte televizioni në ato vite në Shqipëri, e prej andej të përcillte me të njëjtin vektor ato mesazhe mrekullie që kishte perceptuar dikur nga ana tjetër e ekranit. Sepse kjo është magjia e mediave televizive sot, krijojnë imazhe, manipulojnë imazhe, dhe janë një pushtet më vete shumë i fuqishëm se gjithë mediat e tjera, duke përcjellë mesazhe dhe imazhe me një shpejtësi marramendëse.

Prej këtej rrodhi ajo që askush nuk kishte imagjinuar, një balerin i vetëm arrin të bëjë atë që për shumë vite nuk kishte ditur të bënte shteti shqiptar. Italianët zbuluan një tjetër lloj shqiptari, të parrezikshëm, punëtor, kreativ dhe artist, e madje edhe të bukur, sipas kritereve të një bukurie mesdhetare që tundon italianet. Dhe për Shqipërinë filloi të flitej si për një vend normal, që paku i kishte shkuar ndërmend në Italinë provinciale para se në ekran të rrefejej historia e Kledit. E njëjta histori që më pas u shndërruar në film, për të mbledhur në minutazhin e një filmi artistik atë që mund t'i ndodhë një balerini të talentuar shqiptar që i mbërritur në Italinë e vështirë, i takon të çajë përpara mes mijëra problemesh dhe rreziqesh për tu keqpërdorur nga të fortët e sektorit. Derisa ngjarjet morën për mirë, kur audicion pas audicioni ajo që vllente tashmë nuk ishte më shtetësia dhe prejardhja e dyshimtë e balerinit por vetëm dhe vetëm talenti i tij, dhe premtueshmëria e konsiderueshme.

Kjo duket në film, dhe po ashtu te duket edhe në librin e sapodalë në treg që edhe pse në ditët e para, është duke shënuar rekorde shit-



Meqë pjesa më e madhe e sa ndodh në jetë kalon nëpër këtë itinerar sforcimi dhe rrallë ndodh të dhurohet diçka, Kledi nëpërmjet "Meglio di una favola" tregon atë që nuk duket, vitet e gjata të punës, që fshihen pas Kledit të suksesshëm sot

jesh dhe porositjesh kopjesh pranë shtëpisë botuese.

Por ky libër nuk është një kënaqje e narcisizmit prej personi publik që shpesh i shtyn njerëz të njohur të hedhin në treg libra të pamotivuar për tua ofruar fansave të tyre. Përkundrazi, Kledi që ngelet modest sikur sapo të kish zbarkuar në botën e spektaklit italian, synon të japë mesazhe të konsoliduara nga përvoja e tij e gjatë personale në Shqipëri dhe në Itali. Bëhet fjalë kështu për një libër që shkon përtej komerciales, dhe si rrallë herë i ofron publikut të tij të përbërë kryesisht nga fansa të rinj në moshë një shembull të mirë për të ndjekur, drejt realizimit të objektivave dhe ëndrrave të tyre. "Sepse asgjë nuk arrihet

vetëm në sajë të fatit" thotë Kledi, duke dashur tu përcjellë gjithë lexuesve të tij dobinë e disiplinës që e ka shpënë në të tilla nivele suksesi dhe fame. Është ky një mesazh i admirueshëm që shkon pozitivisht kundër rryme në një botë të rinjsh të mbushur me imazhe arritjesh të lehta që plogështojnë dhe tundojnë shumë më tepër se sa objektivat e realizueshëm pas lodhjes, punës dhe përpjekjeve konstante. Por meqë pjesa më e madhe e sa ndodh në jetë kalon nëpër këtë itinerar sforcimi dhe rrallë ndodh të dhurohet diçka, Kledi nëpërmjet "Meglio di una favola" tregon atë që nuk duket, vitet e gjata të punës, që fshihen pas Kledit të suksesshëm sot.

ma.ru.


INTERVISTA

Shqiptari i Italisë: Pas filmit "Passo a due", jeta juaj përshkruhet në një libër.

Libri është pjesë e jetës sime të jetuar, e të kaluarës sime. Ka disa pjesë të rëndësishme të jetës sime, ndryshimet e mëdha nga pikë-pamja profesionale, dhe nga pikë-pamja personale. Por përveç kësaj janë në këtë libër edhe ato ndryshime të mëdha që Shqipëria dhe gjithë shqiptarët kanë përjetuar gjatë këtyre viteve. Është një periudhë shumë e ngjeshur me data dhe fakte. Libri trajton që nga fillimi, fëmijërinë time, momentin kur kam hyrë në akademinë e Tiranës. Janë në të të tetë vitet që kam kaluar në akademinë e Tiranës. Pastaj siç e dinë të gjithë vjen ajo etapë e jetës sime ku gjithçka ndryshoi. Bëhet fjalë për një etapë që e ndaj edhe me shumë shqiptarë të tjerë, tundimi që pjesa më e madhe prej nesh pati për të lënë Shqipërinë. Kështu flas për tundimin e parë, zhgënjimin, dhe rikthimin në Shqipëri në të njëjtën shkollë, turnetë e ndryshëm që kam bërë me shkollën dhe teatrin e Operas dhe Baletit, pastaj sërish ardhja në Itali por këtë herë me dokumente të rregullta. Të gjitha vështirësitë që një i huaj mund të gjejë në Itali, dhe pastaj suksesi, fitorja. Në këtë fazë historia mbaron, sepse pjesa tjetër vazhdon, dhe të gjithë ata që më njohin e dinë se cili jam unë sot, me se merrem, ku kam lindur e pse jam këtu ku jam.

Pse ndiet nevojën të shkruanit këtë libër? Jo gjithmonë balerinët marrin laps e letër në dorë për të treguar jetën e tyre...

Libri flet për ëndrrën për të realizuar suksesin - them sukses duke e përgjithësuar, por do të ishte më e përshtatshme të thuhej objektivat e gjithsecilit në jetë. Libri përbehet, të themi, nga përpjekjet që i duhen kushtuar pikërisht mbërritjes së këtij objektivi. Nuk do të thotë kjo se kjo është mënyrë e vetme për të gjithë, por në rastin tim është mënyra që dha rezultat. Kam dashur të tregoj këtë eksperiencë, sepse mendoj se është një arsye e mirë për tu dhënë një shembull të mirë të rinjve se si të arrijnë objektivat e tyre. Dua që të mos mendojnë se gjithçka varet thjesht nga fati. Fati është një kombinim që lidhet ngushtë me talentin dhe me përpjekjet për realizimin e objektiveve. Natyrisht ky mesazh vlen për këdo, secili në fushën e interesave të veta, jo vetëm për balerinët. Gjithashtu dua të them se këtë libër ia kushtoj gjyshes sime, një njeriu që gjithmonë më ka qenë shumë e dashur



dhe vendimtare për jetën time dhe që fatkeqësisht prej pak kohësh nuk e kam më. Ishte si të thuash edhe një dhuratë për të, duke parë mbrapa nga kjo pikë ku jam tani.

Pra bëhet fjalë për një biografi, përshkruese të gjithë etapave të jetës suaj deri tani. Është edhe një lloj bilanci, ku duket Kleidi i fillimit dhe Kleidi sot. Me pak fjalë si është ky bilanci?

Është një lloj bilanci, është shumë e drejtë. Madje edhe titulli

doli në mënyrë shumë spontane kur isha duke folur me përfaqësuesit e Mondadorit. Nuk mund të kishte titull më të përshtatshëm se "Meglio di una favola". Asnjëherë nuk do të kisha menduar se një ditë do të filloja të bëja kaq shumë gjëra, disa prej të cilave nuk kanë fare të bëjnë me sferën time. Prandaj shkoj më mirë se në përrallë. Është e vërtetë ky libër është një përrallë, që përfundon për momentin në të tashmen. Kuptohet

nuk kishte si të ishte ndryshe përderisa unë nuk jam 70 vjeç tani, jam vetëm 35.

Etapat tuaja nuk mund të mos gërshetohen disi edhe me etapat që ka kaluar edhe emigracioni shqiptar në Itali, shumë shqiptarë mund të gjenin elementë të përbashkët me bilancin tuaj.

Ky i imi është një bilanci i privilegjuar. Ka shumë shqiptarë të tjerë, kolegë të mi, apo të sferave të vijon në faqen 12

vijon nga faqja 11

tjera që i kanë realizuar plotësisht objektivat e tyre në jetë, por unë e ndiej veten shumë të privilegjuar dhe mjaft me fat. Por kur them me fat nuk dua që të mendojnë keq se ishte vetëm fat dhe asgjë tjetër. Duke qenë televizioni një mjet komunikimi që mbërrin shumë më shpejt se gjithë të tjerët, emri im u ka mbërritur njerëzve shumë më shpejt se sa ai një balerini tjetër që shihet vetëm në teatër, apo se emri i gazetarit, apo profesionistit tjetër shqiptar po aq të suksesshëm e të realizuar sa të meritojë famë. Imazhi popullariteti, kanë bërë që të ndihem si pjesë e atyre njerëzve që kanë realizuar ëndrrat e tyre. Por historia ime është e veçantë sepse unë isha një djalë shqiptar që hyri në televizionin italian si shqiptar, që për mua ishte normale, ashtu si për gjithë bashkëkombësit e mi, por që për italianët ishte diçka pak e njohur. Kështu nuk dihej çfarë linim pas, çfarë kishim jetuar, imazhi i anijes dhe i skafeve hidhte pastaj tym të errët mbi gjithçka.

Si është të jesh shqiptar sot krahasuar me të kaluarën?

Opinionin ndaj shqiptarëve është sot shumë ndryshe krahasuar nga ai i shumë viteve më parë. Mendoj se pjesërisht është edhe meritë e atyre djemve e vajzave që kanë dalë në televizion këto vite sepse siç thashë televizioni ka këtë privilegj. Shqiptarët gjithmonë shiheshin si përfaqësues të së keqes, dhe gjithçkaje negative në një shoqëri. Por ardhja e shumë artistëve shqiptarë, natyrisht u tregoi italianëve një fytyrë tjetër të Shqipërisë që bënë që të ndryshonin mendim tashmë për shqiptarët. është një gjë që e shoh edhe tek vetja ime. Unë kur erdha para shumë kohe, këtu thoj "Jam një balerin i teatrit të Operas së Tiranës" dhe njerëzit buzëqeshnin të sjellshëm, por sapo thojta origjinën time, Shqipërinë, ndryshonin menjëherë fytyrë. Tani nuk është më kështu. Të thuash që je shqiptar nuk është më as diçka e jashtëzakonshme as diçka negative. Kjo sigurisht nuk mund të thuhet se ka ndodhur vetëm për meritën time dhe të ndonjë kolegu tim që ka dalë në të njëjtin ekran televizori, është pa tjetër edhe për meritë të atyre mijëra djemve e vajzave që edhe pse nuk janë të famshëm, e nuk dalin në televizor, arrijnë rezultate që i kanë bërë italianët që ndeshen me ta të harrojnë paragjykimet kur dëgjojnë fjalën shqiptarë. Mesazhet e-maillet që të gjithë ne marrim, shprehin mirënjohjen e tyre ndaj nesh, që çojmë lartë dhe përmirësojmë imazhin e shqiptarëve, dhe të flamurit tonë. është diçka që më shkakton

KLEDI KADIU Meglio di una favola



Opinionin ndaj shqiptarëve ka ndryshuar shumë. Jo vetëm për meritën e shqiptarëve të njohur nga publiku i gjerë, është pa tjetër për meritë të atyre mijëra djemve e vajzave që edhe pse nuk janë të famshëm, arrijnë rezultate që i kanë bërë italianët që ndeshen me ta të harrojnë paragjykimet.

shumë kënaqësi por mbi të gjitha më mbush me shumë përgjegjësi.

Megjithatë nuk ka që e lehtë të jeni shqiptar?

Sigurisht kjo sferë, e sporteve apo arteve, është diçka tjetër, është një përjashtim. Kur dikush thotë: jam balerin, këngëtar, apo aktor, është shumë ndryshe nga dikush tjetër që thotë: jam murator, elektrikist, etj pra një punë larg prozhektorëve edhe pse jo më pak të denjë për tu nderuar e respektuar. Unë jam plotësisht kundër kësaj, por për fat të keq njerëzit gjithmonë udhëhiqen nga aparenca. Duhet t'i njohësh më parë njerëzit e pastaj të flasësh për ta, jo të gjykosësh menjëherë për origjinën. Duhet pasur vullnet për të njohur njerëzit, për të njohur tjetrin. Mirëpo kohët e fundit gjithmonë e më shpesh po ndodh që këtu po mbyllen dyert në Itali. Kohët e fundit italianët nuk janë bërë

të ftohtë, por janë bërë mosbesues ndaj të huajve, kjo edhe për shkak të gjërave negative që kanë ndodhur.

Përveç kësaj ka një përmirësim të imazhit edhe duke u nisru nga prania e shumë shqiptarëve tashmë në skenat italiane, Kledi,, Ambeta, Leon Cino...

Po janë tashmë shumë të tillë dhe të gjithë janë cilësorë. Kemi të gjithë pak a shumë të njëjtën histori. Të gjithë kemi ardhur nga Shqipëria, nga ajo shkollë e baletit, dhe kemi trokitur pak a shumë në të njëjtat porta, me të njëjtat vështirësi, por pastaj jemi shndërruar në balerinë të adhuruar nga teleshikuesi italian. Kjo është pozitive. Kuptohet unë ndihem mirë kur shikoj këta kolegë që siç thashë vijnë pak e shumë nga i njëjti rrugëtim që kam ndjekur edhe unë. Sepse ndoshta të ishte një vijon në faqen 14



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizimi falas për të gjithë klientët e rinj deri më 8 mars 2009

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND

vijon nga faqja 12

Kledi i vetëm, apo ndonjë Anbetë e vetme, nuk do të kishin mjaftuar për të ndryshuar opinionin e keq që u krijuar për shqiptarët. Me siguri njerëzit do të thonin "ka nganjëherë ndonjë shqiptar të mirë" siç edhe kam dëgjuar të thonë veçanërisht shumë vite më parë. Tani gjërat kanë ndryshuar, dhe askush mendoj unë nuk habitet më kur dëgjon që dikush është shqiptar por është edhe artistit, del në televizion apo në skenat më të dëgjuara të Italisë për të punuar me koreografët më të mirë të baletit evropian, siç u ndodh tashmë shumë balerinëve shqiptarë. Për mendimin tim, nuk mund të thuhet ende se ka një përmirësim të plotë të mendimit për shqiptarët por ka ndërsa mendimi i keq që mbizotëronte para disa vjetësh është zbehur pothuaj fare, ekziston tani edhe mendimi se shqiptarët janë në përgjithësi njerëz me talente, kuptohet secili në sektorin e vet - nuk mund të jemi të gjithë balerinë - dhe që punojnë dhe përpiqen me ambicie dhe këmbëngulje për të realizuar objektivat e tyre. Megjithatë sot Italia nuk është akoma një vend i hapur mentalisht, kjo është shumë e evidente.

Nuk është absurde një gjë e tillë pas shumë vitesh që emigrantët dhe veçanërisht ata shqiptarë janë më se të integruar e madje janë shpesh herë të suksesshëm?

Kjo nuk ka të bëjë vetëm me mbylljen e italianëve, kjo është edhe injorancë dhe zili. Është diçka që shikoja edhe në rastin tim. Kur fillova të kisha sukses dhe njerëzit më ndalonin në rrugë kur më shikonin, kishte edhe një kategori tjetër njerëzish që hidhnin batuta "pa shih pa shih shqiptarin, ku paska arritur...". Por janë gjëra të cilave nuk u kam dhënë kurrë peshë sepse nuk janë njerëz me të cilët ia vlen të merresh, prandaj duhet të lihen provokime siç janë. Kuptohet që një pjesë e mirë e njerëzve, nuk kanë nivelin e nevojshëm për tu hapur me ata që vijnë nga larg, edhe pse Shqipëria po ta mendosh mirë nuk është edhe aq larg, apo ata që janë të ndryshëm prej tyre, sepse edhe mjetet e informacionit janë shumë provinciale dhe nuk mbërrin informacion. Nëse ti dëgjon një lajm në tg për Shqipërinë apo për Rumaninë një herë në kaq vjet vetëm nëse ka ndodhur ndonjë gjë e kobshme është normale që nuk ke si të dish ndonjë gjë të madhe për këto vende, dhe kur të vjen shqiptari apo rumuni nuk di çfarë të mendosh për të. Në të tilla kushte vetëkuptohet që njerëzit priren të mendojnë keq për atë që nuk e njohin. Pastaj përveç që nuk



KLEDI KADIU

ofrohet informacion, dihet që njerëzit tani nuk mund të shkojnë të gërmojnë për të zbuluar nga vinë shqiptarët apo rumunët, ndërsa duhet të lëvizin si të munden për të mbijetuar.

Ka një lloj radikalizmi të ksenofobisë, gjithmonë çuditërisht në kah të kundërt me zhvillimin e emigracionit në Itali. Nga ana tjetër vetëm pak muaj më parë edhe ju pësua një provokim, në ambientet e shkollës suaj.

Ishte një episod që u fry tej mase, por nuk ishte diçka që mund të quhet racizëm. Ishte thjesht një sjellje jo e ndershme e një njeriu që u gjend në një ambient prindërisht, dhe që u soll keq nuk ishte kundër Shqipërisë apo shqiptarëve. Mund të thonin edhe "napoletano, torinese apo milanese di merda", nuk besoj se ky mund të cilësohet si një episod racizmi. Unë sot nuk ndihem i huaj në këtë shoqëri, dhe mendoj se edhe gjithë shqiptarët e tjerë që kanë kaq shumë vite sa unë këtu, nuk duhet të ndihen të tillë. Prandaj edhe diskriminimi që mund të ekzistojë sot është njësoj si diskriminimi midis italianëve, sepse duam nuk duam ashtu si edhe kalabrezët, napoletanët apo torinezët që jetojnë në Romë për shembull edhe ne jemi pjesë e kësaj Italie që ka kaq shumë pjesë të ndryshme brenda.

Ju shpesh herë cilësoheni si një promovues i përmirësimit të imazhit të Shqiptarëve në Itali. Por këto lloj spektaklesh shikohen kryesisht nga një publik adoleshentësh, a arrin mesazhi juaj deri tek politikanët 60 vjeçar?

Politikanët 60 vjeçar nuk shikon spektaklet e mia, por përsëri edhe adoleshentët nuk i shikojnë vetëm ato spektakle, i shikojnë me prindërit, kështu që mesazhi ka të bëjë me një pjesë të shoqërisë që është përtej asaj grupmoshe për të cilët kryesisht prodhohen këto spektakle. Por nuk duhet të funksionojë kështu. Nuk duhen mbajtur sytë nga televizioni për të përmirësuar imazhin. Duhet të bëjë pjesë në kulturën e individëve, ndërsa në të vërtetë pjesa më e madhe e njerëzve janë të mbyllur, nuk kanë aspak kuriozitet për të njohur kulturat e tjera, njerëz të tjerë, vende të tjera. Sot një përqindje e mirë e teknologjisë sot është çuar përpara nga të huajt. Është e lehtë

të vjellësh ksenofobi me idenë se të huajt janë aty për të bezdisur. Por këta të huaj çojnë përpara vendin ku kanë ardhur dhe emrin e vendit prej nga vijnë. Për fat të keq ka shumë injorancë. Pastaj janë mediat, që edhe ato kanë përcueshmëri të madhe të mesazheve të tyre, por që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë t'i pikturojnë të huajt me ngjyrat më të errëta. Tani protagonistë janë rumunët ashtu siç ishim ne para dhjetë vjetësh. Nuk bëhet fjalë për imazhin negativ vetëm të Shqipërisë por të çfarëdolloj të huaji. Kronika e zezë zë pjesë në faqe të parë të gjitha medieve, prandaj edhe njerëzit janë të bombarduar me lajme të këqija që kanë për protagonistë gjithmonë emigrantët. Shpresoj që përveç kësaj të bëhet edhe një promovimi i pozitivës që kanë këta të huajt. Dihet që këtë e ka bërë media që ka baltosur figurën e të huajve si më keq ka mundur. Kuptohet që nëse ti hap edicionin e lajmeve me kronikën e zezë dhe në fillim fare thua ja shqiptari, ja rumuni ka bërë këtë krim makabër dhe flet për të 10 minuta, ndërsa lajmin e fundit ia dedikon të njëjtit lloj krimi por që e ka bërë një italian, dhe atëherë i kushton më pak se një minutë, kuptohet që ai italian që dëgjon lajmet do të bombardohet më këtë propagandë negative dhe nuk ka se si të krijojë simpati për të huajt. Kuptohet po të shohë një të huaj do të ruhet, do ta shmangë se do të thotë, ky është si ai që dëgjova në lajme. Sado që ne kemi bërë peticione të shumta, e letra të hapura gazetarët italianë mbeten të njëjtë. Më vjen keq për rumunët që po kalojnë atë që kemi kaluar ne në vitet '90.

Po cili është stereotipi i shqiptarëve sot sipas jush?

Dikur ishte gjithçka negative, sot nuk është më kështu. Sot nuk janë shqiptarët në shënjestër. Natyrisht në vitet '90 ka ndodhur edhe ndonjë episod negativ por kjo nuk do të thotë se duhet të hidhet baltë mbi një popull të tërë. Është një arsyetim shumë i thjeshtë ky. Edhe për italianët tek e fundit thuhet se janë mafiozë, por kjo nuk do të thotë se unë personalisht duhet të konsideroj Italinë si një vend mafioz, sepse ka shumë njerëz të mirë, dhe të këqij nga ana tjetër, si të gjitha vendet. Personalisht në jetën e përditshme kam të bëjë me tipa të ndryshëm njerëzish, por takoj edhe shumë italianë të mirë, që kur mendon për stereotipin që qarkullonte dhe që ndihet nga pak edhe sot në Zvicër apo në Gjermani, se ata janë mafiozë, çuditësh dhe thua si ka mundësi. Prandaj unë jam kundër stereotipave sepse janë vetëm paragjykime të gënjeshtërtë, asgjë më shumë. Janë gjëra që krijojnë vetëm probleme.

”

Është gjithmonë shumë bukur kur shkoj sepse shikoj gjithmonë një Shqipëri të ndryshuar, të përmirësuar. Edhe pse jo gjithmonë ata që jetojnë atje e ndiejnë këtë. Ndërsa për sa i përket anës profesionale, burokracia atje është gjithmonë e më e ndërlikuar dhe kjo nuk lejon që të arrihet asgjë pozitive.

Përveç kësaj nuk kisha programuar që një ditë do të bëhesha madje edhe aktor, do të isha i ftuar në kaq shumë spektakle, e në fund si po ndodh këto ditë se do të botoja edhe një libër, biografinë time, e se do të kisha kaq shumë fansa. Kuptohet si gjithë balerinët edhe maksimumi që mendoja se do të arrija në lidhje me publikun ishin duartrokitjet pas shfaqjeve por gjërat rrodhën shumë më mirë. Prandaj edhe libri titullohet kështu. Unë e kisha shkruar dhe nuk kisha asnjë ide për titull. Kur shkova të bisedoja me njerëzit e Mondadorit, njëri prej tyre tha: e si tjetër mund ta titullosh jetën tënde përveç se "Meglio di una favola", dhe unë nuk kisha ç'të komentoja. Pranova menjëherë.

Po me Shqipërinë si janë marrëdhëniet tuaja pas kaq vitesh, dhe natyrisht me baletin shqiptar?

Në Shqipëri shkoj shumë shpesh sepse atje kam familjen dhe të afërmit. Kuptohet që ngelem shqiptar

gjithmonë një cilësi të mirë por kushtet janë të tmerrshme. Balerinët bëjnë prova në salla me temperaturë 0 gradë apo -2 gradë. Nuk ka as kushte më minimale që balerinin të vërë trupin e tij në gjendje pune sepse punohet me trup. Të mos flasim pastaj për veshjes, etj. Kjo është një gjë që më irriton tej mase, sepse baletit shqiptar i ka mundësitë të prodhojë gjëra cilësore dhe të përmirësohet prandaj më vjen keq që të vuajë akoma sikur Shqipëria sapa të kishte dalë nga komunizmi. Është e tmerrshme ta imagjinosh në ç'kushte punojnë balerinët në Tiranë.

Cilat janë projektet tuaja të ardhshme? Plane për të kontribuar në baletin shqiptar?

Projektet janë ato që kam pasur. Amici, promovimi i librit, shkolla e baletit që kam në Romë etj. Kurse për të shkuar në Shqipëri e për të kontribuar mendoj se nuk janë ende kushtet e përshtatshme. Për



Profesionalisht përse zgjodhët Italinë?

Unë erdha në Itali sepse në Tiranë bëhej vetëm balet klasik, dhe unë doja të eksperimentoja dhe të përmirësohesha, edhe në lloje të tjera baleti që shikoja në televizor dhe që më pëlqenin, pro që nuk dija se si t'i kërceja. Kështu vendosa të nisësja. Kisha një bazë shumë të mirë kuptohet dhe kështu u nisa. Historia ndryshoi në të mirë, dhe unë përfitova, natyrisht nuk do të kisha mbërritur këtu nëse Shqipëria nuk do të dilte nga izolimi.

Çfarë ju ka sjellë Italia?

Shumë përmirësim, pa tjetër, por nuk është vetëm Italia. Mendoj se do t'ia kisha dalë me punë dhe përkushtim edhe diku tjetër. U bëra njeri i famshëm dhe kjo është diçka që nuk e kisha programuar.

dhe e ndjek Shqipërinë me shumë vëmendje. Është gjithmonë shumë bukur kur shkoj sepse shikoj gjithmonë një Shqipëri të ndryshuar, të përmirësuar. Edhe pse jo gjithmonë ata që jetojnë atje e ndiejnë këtë, ne që e shikojmë herë pas herë e ndiejmë tej mase ndryshimin. Ndërsa për sa i përket anës profesionale, burokracia atje është gjithmonë e më e ndërlikuar dhe kjo nuk lejon që të arrihet asgjë pozitive. Mund të të vijnë ide të mira, por kur mendon tu hysh me andreve të burokracisë së artit shqiptar stepesh dhe heq dorë sepse artisti duhet të punojë jo të lodhet me humbje kohe. Për mua gjithë ajo burokraci është humbje kohe. Pastaj është shumë e vështirë për brezin e ri të hyjë në këtë art dhe prandaj ka pak prurë të reja nga sa kam parë. Baletit shqiptar ka

të kontribuar në Shqipëri duhet të jem atje dhe për momentin nuk mund të planifikoj të tilla iniciativa. Është një ide shumë e mirë, më duhet ta pranoj. Cilido shqiptar mendoj që ka arritur diçka jashtë shtetit do të ishte i prirë të kthehej në Shqipëri dhe të ofronte edhe ai kontributin e vet. Veçanërisht në arte, e veçanërisht ata që si unë apo të tjerë kanë të bëjnë me këtë fushë që ka shumë për të ofruar në Shqipëri. Por tani për tani kam vënë rrënjë në jetën time të kë-tushme dhe është vështirë të nis gjëra të tjera. Por e ardhmja do të sjellë të tjera gjëra, që ndoshta tani nuk jam as në gjendje të imagjinoj. Sidoqoftë lidhja ime me Shqipërinë ngelet e hapur.

Bisedoi Marjola Rukaj

Cerco di aprirmi un varco in direzione della porta ma non e' semplice. La gente e' come impazzita. Tutti a spingere. Sembra che abbiano paura di non riuscire a scendere. Siamo talmente ammassati che se sollevo i piedi da terra rimango sospeso. Finalmente, dopo circa dieci minuti, riusciamo ad uscire dal treno.

"Di qua, stammi vicino e attento a non perdermi di vista!" esclamo.

Iniziamo a seguire la folla. L'arrivo ha ricaricato completamente le batterie e neanche il caldo torrido e insopportabile sembra riuscire a contenere l'euforia. La stazione e' al centro della citta' di Durazzo che pur non essendo uno splendore dal punto di vista architettonico, rimane una meta molto gettonata per la vicinanza al mare.

Appena fuori nell' enorme piazzale antistante, ci rendiamo conto che la situazione e' piu' caotica del previsto. Oltre a noi infatti c'e' tantissima gente in strada. Macchine e clacson impazziti sono la cornice perfetta di questo quadro che sembra esser stato dipinto da un Eduard Munch in grande spolvero.

"Che macello!" esclama Alioni. "Te lo ripeto! Stammi vicino, seguiamo il flusso e cerchiamo di non perderci! E' tutto ok!" gli dico con un tono un po' piu' autoritario.

Tento di imprimere sicurezza alle parole ma, onestamente, non credo di essere molto convincente, ne' con Alioni ne' tantomeno con me stesso. A torso nudo, con un pantaloncino e un paio di infradito abbastanza consumate iniziamo la nostra marcia. L'asfalto e' rovente.

"Guarda la' Kledi, sono posti di blocco.." mi sussurra Alioni con un filo di voce in un orecchio.

In effetti ci sono militari ovunque. Schierati in posti di blocco, ma non operativi. Cosa abbastanza strana se si pensa al metodo di repressione del regime Comunista. Sembra quasi che il loro intento sia quello di lasciarci comunque andare.

Sembra o...lo e'? Che qualcuno volesse agevolare il nostro esodo per poter creare disagio? "Si Alioni, sono posti di blocco...ma.. osservali bene, non stanno fermando nessuno..ora cammina e non fermarti" lo

Certi sogni partono da lontano, e grazie alla tenacia, al talento, alla passione, arrivano più in alto di dove si sarebbe anche solo potuto immaginare.

Quando è salito sulla Vlora, la nave tristemente nota che dall'Albania trasportava in Italia un carico disumano di esseri umani, Kledi aveva solo un paio di pantaloncini, delle infradito consumate e una grandissima passione per la danza. Era la forza del sogno che lo spingeva ad andare avanti, nella stiva in mezzo a una folla di disperati, sulla banchina del porto a lottare per un po' d'acqua da bere, rinchiuso dentro lo stadio di Bari, e poi in fuga in mezzo alla campagna e braccato come una lepre. Quella voglia di arrivare che gli ha fatto stringere i denti alla severissima Accademia di danza di Tirana, e sopportare le tante mani in faccia, in mezzo a tante mani tese, nella vita da clandestino qui in Italia. Poi è arrivata la fortuna, Maria De Filippi, Amici e tutto il resto. Che se ci pensa adesso, ancora non ci crede. E quando vede una folla di ragazzi, tutti accalcati in una piazza per guardare lui che balla, non può fare a meno di pensare a quella nave, da dove è partito, sembra una vita fa. Questo libro è una storia esemplare che diventa romanzo. Sono pagine di un'intensità sorprendente, un saliscendi di emozioni e avventure che lasciano a bocca aperta. E alla fine il sorriso di Kledi sembra dire di non abbandonare mai i propri sogni, perché le fiabe forse esistono davvero.

KLEDI KADIU

MË MIRË SE NJË PËRRALLË PJESË NGA LIBRI



Botojmë këtu një pjesë nga libri autobiografik i Kledi Kadiut i sapobotuar nga Mondadori. Shqiptari i Italisë falënderon autorin dhe botuesin për lejen e botimit.

KLEDI KADIU
Miglior di una favola (La mia vita)
Mondadori, 2009
240 faqe
17 Euro
ISBN: 978880458448

rassicuro.

"Sai cosa penso?" mi dice lui con un po' di fiateone.

"Cosa?"

"Non so se stiamo facendo la cosa giusta...mia mamma e mio papa' non sanno nulla, i tuoi nemmeno, non staremo forse esagerando?"

Nei suoi occhi e nel tono della sua voce leggevo i miei stessi interrogativi.

"Beh Alioni, io credo che potremmo, come dire, andare a dare un'occhiata no? Non e' mica detto che dobbiamo partire per forza! Stai tranquillo, non ci accadrà nulla". Spero. "Mentre ci affrettiamo con passo spedito, la situazione intorno a noi e' tragicomica. Un pazzesco viavai di persone. Tutti nella stessa direzione.

"Mamma mia..guarda la' Kledi!" mi urla Alioni sorridendo.

Giro lo sguardo e accanto a noi alcune macchine in fila. Per essere precisi, un Taxi e diverse utilitarie. La cosa incredibile e' che in media trasportano dalle dieci alle quindici persone! All' interno, sui cofani, sui tettini, nei bagagliai! Gente ovunque! "Andiamo, non ti fermare!".

Non so se sorridere o essere

preoccupato. Credo che quell'euforia sia in verita' una vera e propria maschera che nasconde l'ansia di ognuno di noi. L'aria e' sempre piu' afosa. Sembra che qualcuno abbia acceso dei giganteschi phon. Dalle finestre delle case la gente ci guarda con occhi sbarrati, privi di una qualsiasi emozione. Attraversiamo tutta la citta' a piedi fino ad intravedere finalmente un scorcio azzurro. Il mare.

Il profumo dell'aria salmastra ed una leggera brezza mi accarezzano il volto. Per un attimo mi immobilizzo chiudendo gli occhi, respirando profondamente. E' una sensazione meravigliosa. Mi riporta alla mente il ricordo delle giornate estive, nei periodi di vacanza, passate con la mia famiglia a casa dei miei zii.

Era divertentissimo. Ogni anno non vedevo l'ora che arrivasse il mese di Agosto. Era bellissimo ritrovarsi tutti insieme, al gran completo. Gli zii, i miei genitori, i nonni, i cugini e mia sorella Ada. Ada...se solo immaginasse in quale situazione sto per cacciarmi mi prenderebbe a pugni sul muso, ne sono certo...con

quel caratterino che si ritrova poi... La gomitata e le urla di un uomo che comincia a correre, mi fanno sussultare. Apro improvvisamente gli occhi e sento le urla di Alioni. "Dai Kledi, che aspetti! Corri! Corri!"

E' gia' una ventina di metri avanti a me e sta correndo. Tutti hanno iniziato a correre. Istintivamente inizio ad inseguirli.

"Aspettami! Alioni! Aspettami!". Mi chino velocemente per togliermi le ciabatte, infilando tra il dito indice e medio delle mani. A piedi nudi si corre meglio.

Col fiatone e il cuore che batte, mentre corro mi guardo intorno. Sembriamo api. Sciami di api che si muovono istericamente verso una meta comune. I piedi bollono sull'asfalto incandescente. Proprio nel momento in cui credo di non farcela piu', ecco che si presenta davanti a i miei occhi lei.

Vlora. Questo c'e' scritto. Vlora. Un nome che non dimentichero' mai. Non e' una bella ragazza ma una nave merci, un gigantesco colosso di non so quanti metri. Tutta bianca. E' attraccata in una zona solitamente riservata al carico/scarico di carbone e per raggiungerla, bisogna attraversarne vere e proprie montagne.

Mentre iniziamo ad avvicinarci al molo, molte persone stanno gia' salendo a bordo. In ogni modo. Dalle passerelle, dalle funi, sembra un assalto ad un carico d'oro da parte di una gigantesca comunita' piratesca. Qualsiasi mezzo per mettere i piedi su quella nave e' lecito, anche rischiando di farsi male....ma in fondo, quale dolore potrebbe essere tanto forte da sovrastare la voglia di volar via verso un nuovo futuro?

I miei occhi e quelli di Alioni si incontrano per un istante. Credo che nessuno di noi due abbia il coraggio di parlare. "Andiamo..." gli dico io. Lui non risponde, mi guarda e ricomincia a correre. In quel momento capisco che siamo ufficialmente in viaggio verso l'Italia.

Col fiatone, sudati, ammassati e compressi ci avviciniamo sempre di piu'. Alle spinte e alle gomitate, ormai, mi ci sono abituato. Siamo completamente neri a



Kledi në kopertinat e Shqiptarit të Italisë, në Janar 2005 ndërsa fillonte xhirimet për filmin e tij "Passo a due" dhe në Qershor 2004, me Ilir Shqipërin, pas marrjes së titullit Ambasador i Kombit nga Presidenti shqiptar



causa della fuliggine. Si fa fatica a respirare, in bocca ho un sapore disgustoso e la gola e' tremendamente secca. Guardo Alioni e trovo comunque la forza di sorridere.

"Ma ti sei visto?" mi dice lui.

"Io? e tu? Sembri il pulcino Calimero!"

"Con questo caldo e questa polvere faccio fatica a respirare..."

"Tranquillo fratello, ancora pochi minuti e saremo su" Pochi minuti un corno.

Dopo circa cinque ore di pressione, sgomitamenti e litigate, riusciamo finalmente a salire a bordo. Appena sul ponte mi volto esausto verso il molo. La nave e' stracolma e, a terra, ci sono almeno altrettante persone che devono e vogliono a tutti i costi salire.

Mi fermo per un attimo a guardarli. La mia attenzione viene catturata dai capelli biondissimi e lunghi di due ragazze. Stanno ricevendo una piccola sacca da due persone anziane. Probabilmente contiene cibo. Le baciano e scappano via di corsa verso la folla. Chissa' cosa penseranno di me i miei familiari.

E Nonna? Stara' male? Papa'? Sara' deluso?

Macche', dovrebbero esser fieri di me....si, se andra' bene li sitemero' tutti....e se morissi? No, assolutamente da escludere. Non e' possibile. Ma se accadesse? Vale la pena di correre un rischio cosi'

grande?

"Kledi.."

"Kledi.."

"Klediiii!"

"Oops, scusami Alioni, stavo pensando a chissa' quando riusciremo a salpare..".

Bugia.

"Tranquillo, vieni dai. Ho incontrato degli amici. Dicono che hanno trovato una sistemazione abbastanza confortevole sotto coperta, potremo passare la notte con loro".

Non ci posso credere. In mezzo a tutta quella gente, Altin, Vajkal e Keta. Tre amici carissimi di mio cugino che vive a Durazzo.

"Kledi! Che bello vedere delle facce amiche!" Altin mi abbraccia sbattendo i suoi due grossi palmi delle mani sulla mia schiena, cosi' forte da provocarmi un colpo di tosse.

"Ciao Altin! Come stai!?"

"Benone, benone. Un po' stanco ma benone. Dai, non perdiamoci in chiacchiere. Seguitemi. Scendiamo sotto coperta prima che ci soffino il posto!"

Scendiamo delle scale abbastanza strette facendoci largo tra la gente. Menomale che Altin e' un bel ragazzone! In mezzo a quella calca e' la nostra personalissima nave rompighiaccio!

Estratto da

Kledi Kadiu, Meglio di una favola (La mia vita) Mondadori, 2009.



Specialisti për fluturime charter, low cost, fluturime linje dhe tragete

• Tiranë
• Durrës
• Vlorë

Bonus për ulje çmimi prej 20 eurosh, nëse na telefonon e thua "Offerta giornale"!!!

Prenotime Fluturim, Hotel, Makina me qira, Tragete dhe Trena në Shqipëri edhe me telefon, me çmime konkurruese.

TURISADRIA VIAGGI
VIA MAZZINI 119/C 47042 CESENATICO (FC)
Tel. 0547.82492– 0547.674221 - 340.7089484
www.volialbania.it

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetmi zë në gjuhën shqipe në shtypin italian

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

*- Kursen 20% nga çmimi në
pikëshifjet e gazetave
- Gazeta të mbërrin drejt e në
shtëpi pa asnjë shpenzim
të mëtejshëm*

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.

BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

Pas dy vjetësh rravgimi nëpër qendra të ndryshme artistike, kthehen në Bolonja, skafistët Arta Ngucaj dhe Ben Beqiraj. Me projektin e tyre Trafik, këtë herë në trajtën Scaf-scaf, që flet më qartë se emërimet e deritanishme. Me projektin e tyre Trafik, këtë herë në trajtën Scaf-scaf, që flet më qartë se emërimet e deritanishme. Bëhet fjalë për një projekt arti bashkëkohor, me ndërthurje të elementeve më eklektike të këtij lloji arti, në një vepër shumë shprehëse që të dy artistët vlonjatë synojnë të përdorin për të komunikuar me kulturën në të cilën janë transferuar, e veçanërisht në qytetin ku jetojnë në Bolonjë. Projekti që u vendos më 23- 28 janar në kuadrin e Off Arte Fiera të Bolonjës synon të shtrojë sërish disa pikëpyetje që prej kohësh nuk shtrohen më në rutinën e informacionit të kronikës aktuale që nuk shkon thellon përmbajtjen. Dhe ndërsa për skafet e famshme të shqiptarëve që vezullonin radarëve si piratë të hakërryer tashmë nuk flitet më sepse skafet në Shqipëri e shumta mund të përdoren për ndonjë vozitje anës detit e madje për shumë kohë qeveria Berisha u dha urdhër të ndryshkeshin parqeve, në Itali, fantazma e skafit është pak a shumë një mjet që u shoqërizohet shqiptarëve, në të njëjtin kuptim që mbulon një të panjohur gjysmë barbar të ardhur nga larg për arsye të dyshimta dhe që duhet marrë me rezerva, si të thuash si kali për mongolët në kohë shumë të shkuara në tjetra mendësi popujsh.

Pikërisht për këtë arsye dy artistët vlonjatë kanë vendosur të merren pikërisht me këtë simbol dytësor të shqiptarëve, tani që skafet nuk ekzistojnë më, që shqiptarët janë diçka tjetër krahasuar me kohën e largët të skafeve këtë herë për të vendosur një urë lidhëse nëpërmjet një skafi edhe më transportues se ata të viteve '90.

"Projekti i fundit, "Trafik, vajtje ardhje" lind nga një kritikë pas punës së parë kur u hap galeria e arteve moderne të Bolonjës Mambo, një godinë për para së cilës edhe banon për ironi vetë autorja Arta Ngucaj. Ideja lindi kur ajo dhe shoku i saj i artit Ben Beqiraj ekspozonin veprat e tyre, dhe në një nga kritikët artistike, dikush i quajti miqësisht "Scafisti Scafati" duke ditur që të dy artistët shqiptarë janë



Skafi i trafikut mbërrin në Bolonjë



Skafistët Arta Ngucaj dhe Arben Beqiraj kthehen në Bolonja, më 23- 28 janar në kuadrin e Off Arte Fiera të Bolonjës. Me skafin e tyre synojnë të shtrojnë sërish disa pikëpyetje që prej kohësh nuk shtrohen më në rutinën e informacionit të kronikës.

nga Vlora, dhe dihet që Vlora ka mbetur në kujtesën e italianëve për famën e keqe të skafeve. Si çdo kritikë konstruktive edhe kjo u mor pozitivisht dhe kështu lindi ideja e projektit Trafik ku dy artistët shqiptarë u vendosën në vendin e skafistëve, duke marrë një gomone nga Vlora, nga ato që dikur përdoreshin për trafik njerëzor. Por kjo e tyrja, një gomone e çnatyruar

që ka kohë që nuk përdoret më, është e mbushur me tablo.

"Me këtë projekt ne shpresojmë të bëjmë trafikun e fundit që nisët nga Vlora, jo me ngarkesë njerëzore por me art, për të prezantuar jo atë që ndodhi por atë ç'po ndodh dhe që nuk shihet nëpërmjet artit" shprehet për "Shqiptarin e Italisë" Arta Ngucaj duke komentuar projektin. Dhe gomonia

ashtu si edhe skafet e vjetra përshkon të njëjtin itinerar që përshkonin edhe skafet "e linjës së natës" dikur nga Vlora në Otranto. Në momentin që mbërrin në Otranto, një anije tjetër që do të përshkojë së bashku me skafin të njëjtën trajektore bën reportazhin për kalimin nga përmes detit, pastaj në Bolonja, skafi parkohet përpara pallatit të artistëve me drejtimin nga hyrja e muzeut, dhe në faqet e muzeut projekttohet ajo që është ilegale në këtë pikë, pra kalimi nga Vlora në Otranto.

"Me parkimin e gomones përballë muzeut ne në mënyrë simbolike kërkojmë një pikë ankorimi, jemi aty dhe kërkojmë të ankorohemi. Nuk është një mesazh revolte është vetëm një projekt për Mambon dhe të tjera galeri në Itali." Për këtë projekt me Edi Mukën, kuratori i bienales së Tiranës dhe Edi Hila që është jo vetëm artist ndërkombëtar por edhe një nga kuratorët e parë në Shqipëri, dhe docent i akademisë, janë zgjedhur artistët që do të ngarkohen gjatë këtij projekti për t'i sjellë këtë ilegalisht. Por do të ketë edhe një imbarkim artistësh italianë për në Shqipëri. Është një projekt që ka pasur shumë mbështetje në nivel vendor. Dhe vazhdojnë kërkimet për artistë për të çuar në Shqipëri, që të kenë bazën e duhur, sepse "siç dihet - sqaron Arta - ne shqiptarët priremi për t'i marrë gjërat pak shabllon duke mos u dhënë vlerat e duhura, pa i studiuar detajet."

Është një work in progress sepse ka një fillim por nuk ka një mbarim. Në momentin që artistëve shqiptarë do u mundësohet një ekspozitë personale nëpër institucionet artistike italiane në Bolonja, kurse artistët italianë në Shqipëri ofrohen për të bashkëpunuar me linjën e artit modern në Shqipëri.

Kështu pas shëtijtes artistike nëpër galeri, dhe nga një breg në tjetrin projekti vjen sërish në Bolonja, aty ku u ngjiz ideja nga vetë autorët për të dhënë një mesazh më shumë për të afruar dy vendet. Ajo që është më e rëndësishmja dhe për të cilën Ngucaj dhe Beqiraj meritojnë të përmenden është edhe ky bashkëpunim dhe nxjerrja e artit bashkëkohor shqiptar që zhvillohet në Shqipëri nga kornizat izoluese e kufizuese për të ekspozuar jashtë Shqipërisë.

Marjola Rukaj



Trafik
Arta Ngucaj &
Arben Beqiraj
Scafisti Scafati

Bologna
nga 23 deri më
28 janar 2009

Albana Temali - Bolonjë

Që nga 6 deri më 11 janar 2009 teatrot e Rajonit Emilia Romagna e përkatësisht ato të qyteteve Modena, Forlì, Faenza (RA), Correggio (RE) e Casalecchio di Reno (BO) kanë ftuar në skenat e tyre trupën teatrale të formuar nga 30 fëmijë jetimë shqiptarë e boshnjakë. Moshë e fëmijëve pjesëmarrës ishte nga 10 deri në 16 vjeç dhe vinin nga Shtëpia e Fëmijës të Shkodrës dhe Javna ustanova Dom za decu bez roditeljskog staranja të Tuzla në Bosnjë dhe pjesa teatrale e përgatitur titullohej "Tutti i grandi sono stati bambini" (Të gjithë të rriturit kanë qenë fëmijë) me regji të Alberto Grillit. Ky spektakël bënte pjesë në projektin "i Monelli", i përfshirë në Marrëveshjen e Programit Kuadër për Kooperimin e Decentralizuar në Ballkan të promovuar nga Rajoni Emilia Romagna dhe një rrjet prej pesëmbëdhjetë bashkish dhe provincash.


Turneu i shfaqjeve të këtij spektakli nisi më 6 janar 2009 në Teatrin Sorchi të Modenas dhe vijoi më 8 janar në Teatrin "Il piccolo" të Forlisë e më pas, më 9 janar në Teatrin "Masini" të Faenzës dhe me datën 10 janar në Teatrin Asioli të Correggio (RE).

Me një grup studentësh shqiptarë, që studiojnë në Universitetin e Bolonjës, anëtarë të shoqatës studentore USAB u ndodha në shfaqjen e përfundimtare të pjesës teatrale të fëmijëve shqiptarë e boshnjakë që u dha në Teatrin "Testoni", Casalecchio di Reno (BO), mbasditen e 11 janarit 2009.

Salla e mbushur plot na befasoi disi, por edhe dëshmoi për interesin që kjo shfaqje kishte ngjallur te banorët e Casalecchio e bashkatdhetarët tanë, të cilët kishin mbërritur posaçërisht nga qyteti i Bolonjës e zonat përreth për të asistuar në këtë eveniment.

Para fillimit të shfaqjes përshëndetën publikun organizatorët e saj si dhe përfaqësuesit e institucioneve të Shkodrës e Tuzla (Bosnjë).

Regjisori i shfaqjes Alberto Grilli, i cili për realizimin e këtij spektakli bashkëpunoi me Angela Pezzi e Renato Valmori dhe Anna Palumbo (instrumentiste) shpjegoi që pjesa teatrale "Tutti i grandi sono stati bambini", ka si pikë referimi librin "Princi i vogël" të Sant'Exupéry - një libër të cilin fëmijët e kanë lexuar. "Shfaqja tregon pak a shumë për udhëtimin që shumë princër të vegjël bëjnë në botën e të rriturve dhe aty vërejnë të mirat e defektet. - shpjegoi më tej regjisori - Në realizimin e saj jemi nisur nga personazhet kryesore të librit të Saint-Exupéry duke i plotësuar ato apo duke shtuar elemente të reja mbi bazën e propozimeve të fëmijëve dhe emocion-



Një trupë teatrale e përbërë nga 30 fëmijë jetimë shqiptarë e boshnjakë, të moshave nga 10 deri në 16 vjeç, ka vënë në skenë shfaqjen "Tutti i grandi sono stati bambini" (Të gjithë të rriturit kanë qenë fëmijë) me regji të Alberto Grillit dhe ka korrur sukses e duartrokitje të ngrohta në shumë teatro të Emilia Romagnës

MISTRECA**ose të gjithë të rriturit kanë qenë fëmijë**

eve të lindura gjatë punës. Kështu fëmijët kanë qenë edhe autorë të pjesëve të ndryshme. Idetë e mendimet e tyre janë bërë pjesë e spektaklit. Me këtë kemi synuar të vendosim në skenë cilin është vizioni i tyre për botën e të rriturve. Në këtë spektakël imazhi mbizotëron mbi fjalën duke bërë kështu "gjuhën" e tij të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë".

Fëmijëve të jetimoreve të Shkodrës e Tuzla u është krijuar fillimisht mundësia të komunikojnë mes tyre duke shkëmbyer foto e letra, e më pas kanë punuar në distancë për të përgatitur takimin e për të bashkërenduar punën e zhvilluar në laboratorë.

Ndërsa përfaqësuesja e Bashkisë së qytetit të Shkodrës falënderoi në emër të bashkisë iniciatorët dhe realizuesit e këtij spektakli dhe

theksoi se: "Pjesëmarrja në këtë program është një ngjarje e shënuar dhe kjo eksperiencë, fëmijëve do t'u kujtohet për gjithë jetën. Ata kanë krijuar miqësi këtu në Itali me fëmijët boshnjakë e ne shpresojmë që në të ardhmen të vijojnë eksperiencën të tjera, me projekte të reja mes Italisë e Vendeve të Ballkanit".

Shfaqja teatrale "Të gjithë të rriturit kanë qenë fëmijë" e fëmijëve shqiptarë e boshnjake u ndoq me shumë interes nga publiku gjatë gjithë kohës dhe shpeshherë ndërpritej nga duartrokitjet spontane drejtuar interpretimit të "artistëve" të vegjël.

Të vegjlit, me interpretimet e tyre treguan për impenjimin e madh edhe në përvetësimin e gjuhës italiane mbasi kjo ishte gjuha e teksteve të recituara që sh-

push alternohej edhe me përkthime në gjuhët mëmë të fëmijëve.

Nga organizatorët mësuam gjithashtu që kjo eksperiencë, unike në llojin e saj, ruga e ndjekur në realizimin e spektaklit dhe shfaqja përfundimtare do të regjistrohesh në një video, e cila do të ndihmojë në promovimin e kësaj eksperiencë dhe do të dëshmojë takimin e këtyre dy grupeve.

Projekti "i Monelli", objektivat e të cilit janë sociale dhe kulturore, me këtë spektakël arriti qëllimin e tij: zhvillimin e krijimtarisë së fëmijëve nëpërmjet komunikimit teatral duke mundësuar pikëtakime mes fëmijëve të etnive, gjuhëve dhe shteteve të ndryshme me synimin e favorizimit të rrugëve ndërkulturore për një bashkëjetesë e bashkëpunim të frytshëm.



RIFILLON SFIDA.

**DO YOU
CHAMPIONSHIP
RINGO?
2009**



DO YOU RINGO CHAMPIONSHIP. TANI E KE TI RADHËN.

Dje protagonistë në fushë, sot protagonistë jashtë saj: janë "heronjtë" e Kampionatit të shkuar Ringo. Dhe tani, bilbili bie për ty. Mblidh pikët në të gjitha paket, duke filluar nga Ringo Black e rinj dhe Ringo ExtraTime. Nëse përfundon mbledhjen e pikëve brenda 31 marsit merr pjesë në hedhjen e shortit për të luajtur në Championship në qershor 2009. Do të jetë KAKA ai që do t'u ndajë çmimet fituesve. Dhe me pikët e mbledhura, do të kesh menjëherë si dhuratë topin dhe çantën të firmosur nga KAKA. Rregullorja e plotë në ringo.it. Promovim i vlefshëm deri më 31/05/09.

Shuma totale e çmimeve 50.000 €.




DO YOU RINGO?

Si tek të gjithë popujt ballkanikë edhe tek shqiptarët nostalgjia ndaj momenteve të ndryshme historike është e madhe, nganjëherë ajo kthehet në opinion mbizotërues e për ne që jemi të lodhur nga përçarjet kjo nuk është ndonjë shenjë e keqe por një ndjesi e tillë s'duhet të na pengojë për të identifikuar disa të vërteta të anashkaluara. Arbëreshët na kujtojnë rezistencën skërderbegjane, simbolin e mos-asimilimit pra ruajtjen e identitetit që në Shqipërinë osmane ishte bjerrur. Arbëreshët na sjellin ndërmend shkrimet e para në shqip me Varibobën, Rilindjen kombëtare me De Radën, Gavril Darën plakun dhe të riun, Santorin, revolucionarin e studiuesin dantesk Domenico Mauro, Zef Skironë etj., pjesëmarrjen në luftërat e Garibaldit apo politikanë si Françesko Krispi e mbështetjen që ata i dhanë pavarësisë së Shqipërisë, Terenc Toçi dhe të tjerë. Ndoshta edhe ata imagjinonin atdheun e dikurshëm me lavdinë e mesjetës; gojëdhënat mbi heroin tonë kombëtar apo familjet fisnike si dhe letërsia e mëvonëshme romantike kishin ndikuar për këtë. Që edhe një përpjekje që këtë vazhdimësi lavdie ta gjenin tek figura e Enver Hoxhës. Gjithë sa përmendëm më sipër do të ishin elementë të pamjaftueshëm që ata të konsideroheshin gjatë regjimit komunist në Shqipëri si bartës të vlerave pozitive, n.q.s. një pjesë e arbëreshëve nuk do të bëheshin pasqyrues të propagandës zyrtare shqiptare. Ne, vërtet, nga Shqipëria i shihnim ata në mënyrë romantike, si një bashkësi monolite që ruante vlera e tradita, që me dinjitet përballonte jetën e vështirë kapitaliste, e sikur të mos mjaftonte kjo, u dilte koha të meditonin për "dheun e tretur". Natyrisht që vizioni ynë ishte deri diku letraresk por me sa duket kënga popullore "Moj e bukura More si të lashë e më s'të pashë..." e kishte bërë efektin e saj.

Në krye të herës në vendin mikpritës ata gjetën një shoqëri më liberale se ajo që lanë pas për t'u integruar hap pas hapi në progresin social e politik të Italisë për të arritur tek shteti liberal e më në fund tek demokracia italiane e pasluftës së fundit, kur ata do të shfaqnin vullnetin e tyre politik nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe

Kur arbëreshët himnizonin Enver Hoxhën



pjesëmarrjes nëpër parti politike si tek Demokracia Kristiane (DC), Aleanca Nazionale (AN), Partia Socialiste, Partia Komuniste apo në grupe Marksiste-leniniste jashtëparlamentare. Mirëpo në Shqipërinë komuniste do të gjenin mikpritje anëtarët e Partisë Komuniste apo të grupeve jashtëparlamentare të ekstremit të majtë (megjithëse Enveri i kishte shpallur Toliatin dhe Berlinguerin revizionistë në shërbim të kapitalizmit) e për paradoks edhe disa priftërinj të cilët i bashkonte e njëjta doktrinë dhe të njëjtat pikëpamje mbi shoqërinë me komunistët e Tiranës. Këtyre njerëzve, qeveria (shqiptare) e asaj kohe u jepte mandatin që të përfaqësonin të gjithë komunitetin, të flisnin në emër të tij në intervista në TVSH, në takime tipike të propagandës me kolektiva punonjësish apo intelektualësh. U mundësonte takime pompoze me Enver Hoxhën dhe bashkëpunëtorët e tij ku mundësisht ata të deklaronin

solemnisht madhështinë e 'udhëheqësit' si dhe 'prestigjin' e tij ndërkombëtar. Pse jo, edhe pushime luksoze në vilat qeveritare si dhe financime për aktivitetin e tyre politiko-propagandistik në Itali. Nga Universiteti shtetëror i Tiranës do të dërgoheshin profesorë të dalluar për besnikëri doktrinale në zonat arbëreshe të cilët do të kryenin atje të njëjtën punë që "Zëri i Popullit" kryente në Shqipëri. Mbi të gjithë shquhej Nasho Jorgaqi i cili shkroi edhe një libër për arbëreshët enveristë në 'stilin' e tij.

Le t'u hedhim një sy organeve të shtypit të arbëreshëve dhe konkretisht gazetës "Rilindja", organ i Lidhjes italiane për ruajtjen e minoritetit arbëresh. Një numër i saj në korrik 1985, pra pak muaj pas vdekjes së Enver Hoxhës, pjesën më të madhe të artikujve ia kushton kësaj figure, shoqëruar me një fotografi me Mine e Haki Ketën. Skeda biografike është ajo e lëshuar nga komiteti qëndror i PPSH-së. Citohet edhe një letër që diktatori shqiptar i dërgon nipit të De Radës, Josif De Radës, më 1965 ku renditen 'sukseset dhe fitoret' e Shqipërisë socialiste

Le t'u hedhim një sy organeve të shtypit të arbëreshëve dhe konkretisht gazetës "Rilindja", organ i Lidhjes italiane për ruajtjen e minoritetit arbëresh. Një numër i saj në korrik 1985, pra pak muaj pas vdekjes së Enver Hoxhës, pjesën më të madhe të artikujve ia kushton kësaj figure, shoqëruar me një fotografi me Mine e Haki Ketën. Skeda biografike është ajo e lëshuar nga komiteti qëndror i PPSH-së. Citohet edhe një letër që diktatori shqiptar i dërgon nipit të De Radës, Josif De Radës, më 1965 ku renditen 'sukseset dhe fitoret' e Shqipërisë socialiste

PPSH-së. Citohet edhe një letër që diktatori shqiptar i dërgon nipit të De Radës, Josif De Radës, më 1965 ku renditen 'sukseset dhe fitoret' e Shqipërisë socialiste sipas fjalorit enverian. Por ai që spikat më shumë për dashurinë ndaj E. Hoxhës është Mario Brunetti, i cili ka qenë edhe deputet në parlamentin italian dhe tani është Konsull nderi i Shqipërisë në Kalabri. Ja ç'thotë Brunetti në artikullin e tij: "Miqësi dhe vullnet për paqe kam lexuar në shikimin e Enver Hoxhës, i dobësuar fizikisht por i qetë dhe buzëqeshës mbi tribunën e nderit ku isha ftuar më 29 nëntor 1984 me rastin e festimeve për 40-vjetorin e çlirimit nga nazifashizmi dhe vendosjen e pushtetit popullor". Duke lexuar Brunettin nuk është aspak e vështirë që çdokush me imagjinatë të shohë 'kopshthin e lulëzuar' të Europës dhe shqiptarët që rëmbimthi hedhin valle 'në gojë të ujkut' e ç'zezzone të humbësh vijon në faqen 24



Një shtëpi në Tiranë, kushton më pak se një garazh në Romë! Dhe vlera i rritet çdo ditë!



Planimetria e një apartamenti tip dhe lart pamje e simuluar e pallatit. Apartamentet në shitje janë në ndërtim e sipër.

Apartamente banimi në gjelbërimin e parkut të Liqenit, pranë kopshtit botanik të Tiranës.

**Sipërfaqe të ndryshme
Duke filluar nga 800 Euro m²**

K & M Constructions

Tiranë - 069-2080820

Romë - 334-2926786

vijon nga faqja 22

një të tillë udhëheqës! Ndoshta nuk është për t'u habitur aq shumë për këndvështrimin e Brunettit sesa për priftin poet Vorea Ujko apo për atin tjetër Xhuzepë Farako që drejtonte Revistën "Zjarri", e cila citohej edhe nga "Zeri i popullit", që vizitonin shpesh Shqipërinë asaj kohe. Ky organ vdekjen e E. Hoxhës e përcjell me këtë koment: "nuk mund të rrimë pa nënvizuar me këtë rast fuqinë e aksionit të presidentit Hoxha në transformimet kulturore, përveçse institucionale, sociale dhe ekonomike regjistruar në këta 40 vjet".

Këta njerëz të perëndisë hynin e dilnin në të vetmin vend ateist të botës aty ku objektet e kultit ishin përdhunuara e rrënuara ku kleri në përgjithësi qe burgosur dhe eliminuar fizikisht dhe emocion-heshin nga progreset e këtij vendi, nga sukseset e njeriut të ri nga 'legjedari' Enver. Asnjë rresht nuk shkruan për fatin e klerikëve në Shqipëri në shtypin perëndimor kolegët e tyre priftërinj dhe poetë, pena e të cilëve rrëshqiti ëmbël kur përshkruanin socializmin tonë. Ja ç'thotë studiuesi i mirënjohur arbëresh Italo Fortino: "Nëpërmjet një himni të gjatë që mund të konsiderohet një poemë e vërtetë krejtësisht kushtuar figurës së Enver Hoxhës, poezia "Mundësi dhe akt" siç është e lehtë të kuptohet na prezanton shndërrimin e gjërave në tensionin e rindërtimit të Shqipërisë":

"Mundësi dhe akt"

Gjithçka që është në akt

Ka ende mundësi

Të jetë diçka tjetër.

Ashtu ne jetojmë në tension

Për të ngritur ndërtime të reja

Hydrocentrale më të fuqishme

Për të krijuar vepra më të bukura

Për të formuar njerëz të rinj.

Për hir të së vërtetës duhet thënë që kjo poezi si dhe tjetra që do të citojmë më poshtë janë botuar tash së voni, ndoshta Vorea Ujko i trembej ndonjë reagimi të mundshëm të eprorëve të tij kishtarë. Në Shqipëri poezi të tilla qenë shkruar me qindra madje një letërsi e tërë e ndoshta në ato kushte për shkrimtarët tanë mund të gjendet një justifikim i vagët por për një prift poet që jetonte në një vend demokratik si Italia, të cilit nuk i mungonte aftësia intelektuale e krahasimit,

Kur arbëreshët himmizonin Enver Hoxhën



vargje të tilla janë një fyerje ndaj vuajtjeve të një populli. Poezia tjetër që të lë gojëhapur titullohet "Meditim mbi varrin e Enverit":

*Pashë diellin që u ndal
mbi gjoksin e Enverit
Donte të kuvendonte
me një shok të dashur
Edhe ai një diell
Që ndriçoi historinë.*

Parimet estetike do të idhno-heshin së tepërmi nëse do të përdoshin për të komentuar këto vargje. Poeti Vorea Ujko ka pasur fatin të rrëfëhet tek prifti Vorea Ujko por si do t'ia bëjë poeti Kavemell Kandrevë që nuk është prift megjithëse kur bëhet fjalë për mëkatet të rënda siç ishte formimi i njeriut të ri apo himne ndaj Enver Hoxhës mbase zotit i duhet të mendohet pak para se të falë. Le të shikojmë poezinë e Kandrevës e cila ngjason shumë me poezitë tipike që krijonin oficerët në pension, veteranët xhambazë apo kooperativistët e dalluar:

*Me pendë me pushkë me shat
Koha kalon e ëmbël
Me lehtësi...
Pjell toka gjithmonë
Çdo pasuri...*

Këndojnë shqiptarët

Të gëzuar

Jetojnë

Me burrëri!

*Ndërsa 'ferrin' kapitalist italian
e përshkruan kështu:*

Kush vdes e kush gëzon

Është edhe ai që në burgje rron

E ky populli ynë i mjerë

Sot po nëmën e mallkon!

Një rast tjetër, mbase i panjohur për lexuesit, i përçudnimit të gjuhës për ta vënë atë në funksion të propagandës komuniste janë edhe një dy librecë metodikë në formë traktesh për mësimin e gjuhës shqipe të titulluar "Flet Tirana... Flet Tirana" me autorë Enxin Arbëreshin dhe Mustafë Kosovarin, a thua se për saktimin gjuhësor nuk mjaftonin filologët e Tiranës?. Të gjitha dialogjet që do t'u shërbenin të huajve për të mësuar gjuhën shqipe ishin pjesë të shkëputura nga fjalimet e Enver Hoxhës, Mehmet Shehut dhe nga "Zëri i Popullit". Ja një rast: "Fitorja e popullit shqiptar është fitorja e proletariatit rus, italian, gjerman, kinez, amerikan, kamboxhian, algjerian... ashtu si fitorja e popullit vjetnamez është fitorja e proletariatit ndërkombëtar". Si mundëj një amerikan të mësonte gjuhën

shqipe nga kjo e ashtuquajtur metodë e cila demonstroi paaftësi, mosnjohje shkencore dhe vërberi politike n.q.s. ai do të lexonte "Niksoni ishte më i keq se Hitleri", "Qeveritë amerikane janë më të këqija se ato të fashistëve europianë", "Rroftë lufta e popullit vietnamez". Nuk e dimë nëse Enxini e ka revizionuar metodën e tij pas shpalljes tradhetar dhe vrasjes së Mehmet Shehut sepse ai i lë mjaft vend mendimit dhe figurës së tij në këtë sajësë. Ja një pershkrim "Shoku Mehmet Shehu ka qenë dhe është revolucionar i ndërgjegjshëm. Në kohë lufte ai luftoi me shokun Enver e me popullin shqiptar kundër armikut imperialist dhe armikut klasor". Armiku i klasës ishte mesa duket objekti kryesor i hulumtimit i Enxinit dhe Mustafës dhe jo Gjuha Shqipe ndaj së cilës na rezultojnë boll të panxënë.

Ja se ku reduktohet shqipja e Fishtës, Konicës, Naimit apo De Radës në parulla kongresesh dhe demagogji proletare. Urojmë që asnjë i huaj të mos ketë tentuar të mësojë gjuhën tonë me këto metodë se përndryshe shija e keqe s'do ta braktisë kurrë dhe gjuha e zuluve do t'u duket një mrekulli. Pas viteve '90 kur arbëreshët filluan të vinin dëndur në Shqipëri zbuluan një Vend të panjohur, krejt ndryshe nga ç'e dinin sepse një pjesë e atyre që 'ne' i kishim mandatuar si përfaqësues të komunitetit arbëresh të verbuar ose jo nga ideologjia komuniste i kishin gënjer.

Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe arbëreshëve tashmë pas 18 vjet njohjeje dhe komunikimi janë zhveshur nga nostalgjitë. Një pjesë e tyre duke ndërjet peshën e imazhit që mediat italiane kanë krijuar për shqiptarët e përtej detit preferojnë të thirren vetëm kalabrezë, sicilianë thjesht italianë pa dhënë hollësinë e të qenit arbereshë. Por nuk mungojnë as personalitetet me vetëdije të lartë intelektuale që në thelb të këtyre marrëdhënieve kanë matricën etnike të përbashkët dhe jo ideologjizmat ku në universitete si "La Sapienza" i Romës, apo ato të Kozencës, Napolit, Palermos bëjnë një punë të vyer në shërbim të kulturës dhe imazhit të Shqipërisë...

De Rada do të na kujtojë të gjithëve ne "Dhe lis bota kish ndërruar..."

Agron Gjekmarkaj



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

Tregoni historinë tuaj



Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

www.migrart.it



contrasto



Ligi italian parashikon që gruaja shtatzënë, edhe pse lindodhet pa lejeqëndrimi të rregullt në territorin italian, nuk mund të dëbohet deri sa të kenë kaluar gjashtë muaj pas lindjes së fëmijës; ajo ka të drejtë t'i lëshohet një lejeqëndrimi "për kurim mjekësor" (neni 19 pika 2 i d. L. 286/98 dhe neni 28 paragrafi 1 pika C e D.P.R. 394/99).

Kërkesa e lejeqëndrimit duhet të paraqitet ekskluzivisht pranë zyrës së emigracionit të kuesturës, të provincës në të cilën banon, pasi përjashtohet për të tilla rast mundësia e kërkesës së lejeqëndrimit duke dërguar praktikën postale.

Kërkesës i duhen bashkëngjitur:

- një pullë taksë prej 14,62 euro;
- fotokopja e të gjithë pasaportës;
- katër fotografi pasaporte të kohëve të fundit;

- certifikatë mjekësore që vërtetojnë gjendjen e shtatzënisë dhe datën e menduar të lindjes (vlejnë vetëm certifikata mjekësore të lëshuara nga A.S.L. dhe nga Ndërmarrjet spitalore).

Si rregull kuestura pasi ka ekzaminuar kërkesën lëshon fillimisht një lejeqëndrimi për kurim mjekësor të vlefshëm jo për gjithë periudhën e shtatzënisë por për pak muaj. Shtetasja jo komunitare, pas skadimit të tij duhet të kërkojë përtëritjen gjithmonë pranë zyrës së imigracionit të kuesturës.

Përtëritje pas përtëritjeje, gruaja mund të qëndrojë në Itali deri gjashtë muaj pas lindjes së fëmi-

LEJEQËNDRIMI për shtatzëni



Një grua shtatzënë apo që sapo ka lindur mund të qëndrojë në Itali deri gjashtë muaj pas lindjes së fëmijës me një lejeqëndrim për kurim mjekësor. Pas kësaj periudhe, nënë e bir nuk janë më të autorizuar të qëndrojnë në Itali dhe duhet të kthehen në vendin e tyre.

jës. Pas skadimit, shtetasja e huaj dhe fëmija nuk janë më të autorizuar të qëndrojnë në Itali dhe duhet të kthehen në vendin e tyre.


Lejeqëndrimi për kurim mjekësor nuk lejon punësimin dhe nuk mund të konvertohet në ndonjë lloj tjetër lejeqëndrimi, përveç disa rasteve të veçanta (p.sh. kohezion familjar me një shtetas jo komunitar të pajisur me lejeqëndrim dhe që paraqet të gjitha kushtet e nevojshme për bashkimin familjar).

Kujdes: të njëjtën të drejtë për t'u pajisur me këtë lejeqëndrim e ka edhe bashkëshorti pa lejeqëndrim të rregullt që bashkëjeton në Itali, me shte-

tasen jo komunitare shtatzënë.


Gjykata kushtetuese, në fakt, me vendimin n.376 të 27 korrikut 2000, në ndalimin e dëbimit ka përfshirë edhe bashkëshortin bashkëjetues të gruas shtatzënë dhe/ose gjatë muajve pas lindjes së fëmijës. Për të kërkuar këtë lejeqëndrim shtetasi jo komunitar duhet të paraqitet në kuesturë ku të dorëzojë një kopje të dokumenteve të paraqitura nga gruaja, si edhe një kopje të certifikatës martesore (të përkthyer dhe legalizuar nga një përfaqësi italiane jashtë shtetit ose pajisur me "Apostille" për vendet që kanë aderuar në Konventën e Hagës).

Av. Mascia Salvatore



Vittima di razzismo?

KUSH JEMI
U.N.A.R. (Zyra Kombëtare kundër Diskriminimeve Raciale), ka për detyrë kontrollin dhe garantimin e parimit të barazisë së trajtimit, për këdo që është viktimë e një diskriminimi apo shqetësimi të pësuar, për shkak të originës etnike apo raciale. Zyra e re është një pikë referimi për të gjithë ata që duan të jenë të mbrojtur në të drejtat e tyre, kundër çdo forme të diskriminimit racial.



NJË NUMËR PA PAGESË KUNDËR DISKRIMINIMIT RACIAL:
800.90.10.10

U.N.A.R. ka vënë në dispozicion edhe një numër pa pagesë 800.90.10.10, i cili është aktiv çdo ditë nga ora 10:00 deri në 20:00. Qendra me të cilën kontaktoni (Contact Center), është e gatshme t'ju përgjigjet në gjuhët italisht, anglisht, frëngjisht, spanjisht, arabisht, rusisht, rumanisht dhe atë kineze mandarino dhe jep informacione, orienton dhe ofron mbështetje e ndihmë për viktimat e diskriminimeve raciale. Duke telefonuar në këtë numër, mund të denonconi apo të jepni dëshmi për fakte, ngjarje, procedura apo veprime që paragjykojnë, për shkak të racës apo originës etnike, barazinë e trajtimit mes personave të ndryshëm. Contact Center vepron aty ku është e mundur, për zgjidhjen e problemeve ose, përmes ekspertëve të zyrës, shoqëron personat e diskriminuar në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

chiama il NUMERO VERDE GRATUITO
800.90.10.10

Are you a victim of discrimination? Call toll free number.
Victime de discrimination? Appelez le numéro vert gratuit.
¿Eres víctima de discriminación? Llámame al número verde gratuito.
Ты - жертва дискриминации? Позвони по телефону.
Victimă a discriminării? Sună la numărul verde gratuit.
如果你这种歧视的受害者，请拨打绿色免费电话。
ان كنت ضحية تمييز عرقي، فان الرقم الأخضر المجاني.

Sue Ryder Care 
Albania

nëse në shtëpi,
një i afërmi juaj ka një
sëmundje të rëndë...

sot, edhe nga larg mund të besh diçka...

Mund të mbështesësh ekonomikisht
Ryder Albanian, një shoqatë që ofron një
shërbim asistencë domiciliare për të
sëmurët me sëmundje në fazë të avancuar.

Dy ekipe të specializuara ofronjë në
Tiranë dhe Durrës asistencë mjekësore,
psikologjike dhe sociale falas për pacientët
dhe familjarët e tyre.

Jep kontributin tënd në:

Sue Ryder Care Center - Albania
Banka Amerikane e Shqipërisë

Në këto numra logarë të emërtë Shqipërisë
"Ryder Albania"

30 46 393 1801 - EURO

10 407 31801 - ALL (Lek)

Në Italiçka: 06 47 81 11 11 - në Italiçka: 06 47 81 11 11
sëmundje (198) nëse do të jipabëlet i vepërime t.

c/c postale 23184005 intestato a:
Associazione Ryder Italia
Via del Nuoto, 11 - 00194 Roma

shkaku: "progetto Albania"

www.ryderitalia.it - email: ryderalb@cc-al.org

tel. +355 4 340352

Detyrimet fiskale të bashkëpunëtorëve shtëpiake

Ndaj çdo vit, në periudhën maj-korrik, bashkëpunëtorët familjare duhet të verifikojnë nëse kanë apo jo

COLF & BADANTI

detyrimin e përpilimit të deklaratës së të ardhurave dhe të pagesës së taksave.

Çdo bashkëpunëtor familjare (colf, badante, babysitter, etj) përfiton një rrogë në të cilën nuk përfshihen kontributet shoqërore (që derdhen çdo tre muaj pranë INPS-it) por që ka brenda tatimin mbi të ardhurat e personit fizik, të njohur ndryshe si IRPEF. Ligji fiskal italianë parashikon që, për këtë kategori punonjësish nuk ekziston detyrimi i paraqitjes së deklaratës së të ardhurave, por vetëm nëse këto të fundit nuk kapërcejnë një shumë vjetore të

caktuar.

Kështu, nëse një bashkëpunëtor familjare gjatë vitit fiton deri në 8 mijë euro, ajo ka një zbritje nga taksat të barabartë me vlerën e IRPEF-it, në këtë rast ajo nuk i detyrohet shtetit për asnjë qindarkë ndaj ajo nuk duhet të paraqesë deklaratë të ardhurash. Por ekzistojnë edhe forma të tjera zbritjesh fiskale si, për shembull, për fëmijët në ngarkim, shpenzime mjekësore etj. Ndaj nëse të ardhurat vjetore e kapërcejnë shumën prej

8.000 eurove, duhet kontrolluar, nëse bashkëpunëtorja familjare duhet t'i paguajë apo jo para shtetit, pra nëse lind apo jo detyrimi i deklarimit të të ardhurave dhe i pagesës së taksave të mundshme.

Ndaj çdo vit, në periudhën maj-korrik, bashkëpunëtorët familjare duhet të verifikojnë nëse kanë apo jo detyrimin e përpilimit të deklaratës së të ardhurave dhe të pagesës së taksave. Kjo deklaratë quhet 'modello UNICO' dhe duhet

përpiluar në muajt maj qershor. Kjo vlen për të gjithë njësoj, italianë e të huaj.

Për të bërë verifikimin është mirë të shkohet pranë një ekonomisti apo qendrave të asistencës fiskale (CAF) me këto dokumente:

1) modelin CUD (certifikatë e lëshuar nga punëdhënësi brenda majit 2009 që dëshmon të ardhurat e përfuara gjatë vitit 2008). Në fakt, Kontrata kolektive e punës pranë familjeve parashikon që "punëdhënësi,

CONTRATTO

DI LAVORO DI COLF & BADANTI

Rriten rrogat bazë për vitin 2009

Kontrata kolektive kombëtare e punës inkuadron bashkëpunëtorët familjare në tetë nivele sipas detyrave që kryejnë, dhe përcakton rrogën bazë për secilën kategori.

Kontrata kolektive kombëtare e punës pranë familjeve inkuadron punonjësit në tetë nivele (4 të thjeshtë e 4 super) sipas detyrave që kryejnë. Në kontratë përcaktohen edhe rrogat minimale të çdo niveli të kësaj kategorie punonjësish, në marrëveshje mes përfaqësuesve të punëdhënësve dhe sindikatave të bashkëpunëtorëve familjarë.

Nga 1 janari rrogat minimale janë rritur për t'ia përshtatur ato kostos së jetesës. Ja një sintezë e niveleve, e pagave minimale dhe ndonjë shembull detyrash për çdo nivel.

Dal primo gennaio gli stipendi minimi e le indennità di vitto e alloggio che spettano ai lavoratori domestici sono cresciuti di qualche euro. È un aumento previsto dal contratto nazionale di lavoro per adeguare gli stipendi al costo della vita, concordato tra i rappresentanti dei datori di lavoro

e i sindacati.

Niveli A: punonjës që nuk janë punësuar për t'u përkujdesur për ndonjë person, pa përvojë profesionale apo me përvojë maksimale njëvjeçare, që kryejnë punë krahu nën kontrollin e drejtpërdrejtë të punëdhënësit. Minimumi mujor i këtij niveli është 569,52 euro për bashkëpunëtorët familjarë që bashkëjetojnë me punëdhënësit dhe 4,14 euro në orë për ata që nuk bashkëjetojnë. Janë të këtij niveli bashkëpunëtorët familjarë që merren me pastrimin e shtëpisë, ndihmojnë në kuzhinë. Ndërsa janë të nivelit A super, personat që shoqërojnë persona të vetëmjaftueshëm, gratë që mbajnë fëmijët me rastë e për pak kohë. Rroga minimale mujore për këta është 673,07 euro për punonjësit që bashkëjetojnë me punëdhënësit dhe 4,87 në orë për ata me vete.

Niveli B: punonjësi me përvojë mbi njëvjeçare me aftësi specifike

profesionale. Inkuadronen në nivelin B bashkëpunëtorët që mbulojnë detyra të ndryshme, rojet, kamerierët, shoferët. Shumica e bashkëpunëtorëve familjare që pastrojnë shtëpitë (të ashtuquajturat colf) inkuadronen në nivelin B. Në nivelin B Super inkuadronen personat që përkujdesen për të moshuar e fëmijë të vetëmjaftueshëm, që merren edhe me gatimin dhe pastrimin e shtëpisë. Për punonjësit bashkëjetues rrogat minimale janë 724,85 për nivelin B dhe 776,62 euro për nivelin B Super. Për ata që nuk bashkëpunojnë, pagat minimale për orë janë përkatësisht 5,18 dhe 5,49 euro.

Niveli C: punonjës me aftësi profesionale të tilla që u lejojnë të mbajnë shtëpinë në mënyrë krejtësisht të pavarur, pa pasur nevojë për mbikëqyrjen e punëdhënësit. Të këtij niveli janë kuzhinierët, ndërsa të nivelit C Super janë bashkëpunëtorët familjarë (pa diplomë profesionale) që përkuj-

desen për persona jo të vetëmjaftueshëm, që merren edhe me gatimin dhe pastrimin e shtëpisë. Shumica e kujdestareve për të moshuar, të sëmurë e fëmijë të vegjël (të ashtuquajturat badante) inkuadronen në nivelin C Super. Për punonjësit bashkëjetues rrogat minimale janë 828,40 për nivelin C dhe 880,17 euro për nivelin C Super. Për punonjësit që jetojnë më vete, pagat minimale për orë janë përkatësisht 5,80 dhe 6,10 euro.

Niveli D: punonjës të diplomuar për punët me të cilat merren, të cilët në autonomi të plotë administrojnë e koordinojnë punët e shtëpisë. Janë të nivelit D të thjeshtë administratorët e të mirave të familjes, maxhordomët; kryekuzhinierët. Ndërsa në nivelin D Super inkuadronen kujdestarët e personave jo të vetëmjaftueshëm, të diplomuar për këtë profesion (infermierë të diplomuar të përgjithshëm, kujdestarë të diplomuar të moshuarish), që merren edhe me gatimin dhe pastrimin e shtëpisë. Minimumi mujor i nivelit D është 1035,50 euro për bashkëpunëtorët familjarë që bashkëjetojnë me punëdhënësit dhe 7,04 euro në orë për ata që nuk bashkëjetojnë. Ndërsa rroga minimale mujore nivelit D Super është 1087,27 euro për punonjësit që bashkëpunojnë dhe 7,35 në orë për ata që jetojnë më vete.

me kërkesë të të punësuarit, është i detyruar t'i lëshojë këtë të fundit një deklaratë në të cilën të rezultojë shuma e përgjithshme që i ka dhënë gjatë vitit".

2) Kodi fiskal i punonjësit, si dhe i bashkëshortit dhe i bijve në ngarkim. Për bashkëpunëtorët familjare jokomunitare nevojitet certifikata 'stato di famiglia' nëse fëmijët dhe i shoqi janë rezidentë në Itali, ose certifikata familjare e lëshuar në vendlindje, e përkthyer dhe e legalizuar në konsullatën italiane, nëse familja ndodhet në vendlindje.

3) Shpenzime të mundshme mjekësore të bëra gjatë vitit 2008 (vizita te specialistë, ilaçe etj).

Konsulenti apo operatori i CAF-it, pasi shqyrton të gjithë dokumentacionin, është në gjendje të thotë nëse bashkëpunëtorja familjare është e detyruar apo jo të paraqesë deklaratën e të ardhurave dhe të paguajë taksat (IRPEF) në proporcion me çka fituar gjatë vitit.

Mascia Salvatore
www.stranieriinitalia.it

5.317,65 euro të ardhura për të marrë lejen e qëndrimit

INPS-i rivlerëson çekun social për vitin 2009. Për mjedhojë rriten është të ardhurat minimale për përfëritjen e lejeve të qëndrimit dhe për bashkimet familjare

INPS-i e ka vlerësuar në masën 409,05 euro, shumën mujore të çekut social për vitin 2009, një formë asistence sociale për të moshuarit më të varfër.

Ceku u jepet shtetasve italianë dhe komunitarë që janë të paktën 65 vjeç dhe që kanë të ardhura vjetore jo më të larta se 5317,65 euro, pra sa shuma e çekëve socialë për 13 muaj. Shtetasit jo komunitarë mund të përfitojnë këtë të drejtë vetëm nëse janë rezidentë në Itali prej të paktën dhjetë vitesh dhe nëse janë të pajisur me një lejeqëndrim CE për "rezidentë afatgjatë" ose disponojnë një kartë qën-

drimi.

Në të vërtetë gjyshët e imigruar që plotësojnë këto kushte janë të paktë, por ceku është i rëndësishëm sepse shuma e tij e tanishme shpesh merret si parametër referimi nga normativa e imigracionit, për të vlerësuar mundësitë ekonomike të të huajit. Kështu për shembull, për të marrë në 2009 përfëritjen e lejeqëndrimit për arsye pune, duhet të tregohet se së bashku me të gjitha kushtet e tjera fitohen të ardhura prej të paktën 5317,65 euro.

Në të tjera raste kjo vlerë bazë shumëfishohet, siç ndodh për bashkimet familjare.

Për të paraqitur kërkesën,

duhet që të ardhurat të jenë sa shuma vjetore e çekut social, të cilit i duhet shtuar gjysma për çdo pjesëtar të familjes që është bashkuar me familjen në Itali: pra 7.976,475 euro për çdo familjar, 10.635,30 euro për dy familjarë, 13.294,125 euro për tre familjarë dhe kështu me radhë. Vetëm për ata që dëshirojnë të marrin me bashkim familjar dy ose më shumë fëmijë nën moshën 14 vjeç, apo për bërjen kërkesë për dy apo më shumë familjarë nga ana e dikujt që gëzon përkrahje sociale, pragu mbetet i barabartë me dyfishin e çekut (10.635,30 euro).

EP

Sapore di casa



Në një dado-supe të vogël, një kuzhinë e madhe.

KONKURSI ESHTË NE LESHENJENGA DATA 08-11-01 DERI ME 09-03-31. SHKORTI PER RINDRITURIMET BRESIDA DATES 09-04-03. VLERE PERCJUTISHME E COMVE ESHTEDBENIE 0,30 ZBZ PER SHIRTYSH NE PREGJUDICA EPOTE GJEBET NE INTERNET WWW.STRANIERIINITALIA.IT

Me Maggi mund të fitosh një Kuzhinë

Jepi shije specialiteteve tuaja me një dado-supe (ekstrakt) të thjeshtë dhe mund të fitosh një kuzhinë të mrekullueshme.

Blej një konfeksion me dado-kuzhine Maggi, plotësoje kuponin me të dhënat tuaja dhe dërgoje së bashku me kodin me viza të artikullit dhe fletëpagesën (scontrino) në adresën e dhënë: të gjithë kuponët që mblidhen brenda datës 09-04-15 do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për një kuzhinë të mrekullueshme.

Konsulto rregulloren në seksionin e caktuar për kuzhinën etnike në internet www.stranieriinitalia.it dhe zbulo librin e recetave të kuzhinës ndërkombëtare që ofrohet nga Maggi edhe ti mund të dërgosh recetën tënde!



Stranieri in Italia

*campi non obbligatori

Nome _____ Cognome _____

Sesso* F M Residente a: Città _____ Prov _____

Via _____ n° _____ Cap

Tel _____ email* _____

Inserisci i tuoi dati e spedisisci insieme al codice a barre e lo scontrino di acquisto alla casella postale: Vinci una Cucina con Maggi c/o C.S.M. - Casella Postale 150 - 20187 SEGRATE (MI). I dati dei concorrenti serviranno per partecipare al concorso e saranno registrati elettronicamente. Titolare dei dati è Nestlé Italiana S.p.A. - Via G. Richard, 5 - 20143 Milano. Responsabili del trattamento dati sono: CSM - via Brescia, 9 - 20096 - Poglietto (MI); Ogilvyone Worldwide S.r.l. - Via Lancetti, 29 20158 Milano e Intouch - Gruppo Europ Assistance Via Crema, 34, 20135 Milano. Fornendo ulteriore consenso, i dati dei concorrenti potranno essere utilizzati per fini informativi, di ricerca e per l'eventuale invito gratuito di materiale promozionale e pubblicitario da parte di Nestlé Italiana S.p.A. e di Sanpellegrino S.p.A. Ai sensi dell'art. 7 d.lgs. 196/03, i consumatori potranno consultare o far modificare i propri dati od opporsi al loro utilizzo scrivendo a Nestlé Italiana S.p.A. - Servizio Consumatori - Casella Postale 163 - 20101 Milano.

Buono Sconto

482050085

0,30€



Valido per l'acquisto di una confezione a scelta tra Dado Ricetta Mediterranea e Dado Ricetta Originale

AVVERTENZE AL CONSUMATORE - Per ottenere lo sconto il buono deve essere presentato al negoziante entro il 01/06/2009. AVVERTENZE AL RIVENDITORE - Per ottenere il rimborso di questo buono sconto, si prega di inviare il medesimo alla Nestlé Italiana S.p.A. presso VALASSIS S.r.l. - Casella Postale 14250 - Via Grosio 10/B - 20151 Milano. La Società rimborserà questo buono sconto solo se utilizzato dal consumatore per l'acquisto del prodotto. Ogni altro uso verrà perseguito nei termini di legge. Non saranno rimborsati buoni non integri in ogni loro parte o che comunque presentino segni di manomissione o alterazioni. Il rimborso dei buoni potrà essere sospeso qualora venisse rilevata la non corrispondenza tra il numero dei buoni presentati e la quantità di prodotto acquistato.

IR-05-08

accosento

NON accosento

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
13					14		15		16		17	
18			19		20		21		22			
	23					24		25				
26			27						28			
		29			30		31	32		33	34	35
36	37			38			39				40	
41				42		43				44		
45			46			47		48	49			
	50	51	52		53			54		55		
56						57		58		59		60
61			62			63				64		

HORIZONTALISHT

1. Gara më e gjatë e vrapimit. 8. Gyp metalik. 11. Edipi pa teke. 13. Shqetësim i madh. 14. Kafshë dythundrake me brirë të gjatë. 16. Henri, shkrimtar. 18. Përemër vetor. 19. David William, dramaturg amerikan. 21. Dem i tredhur, kafshë pune. 22. Lidh dyfekun. 23. Grupor. 24. Avni, që vrau Esat Pashën. 26. Klub Sportiv. 27. Fshat në Vlorë. 28. Xerox pa xe. 29. Grup Terrorist. 30. Demi pa zanore. 31. Bulka, shkrimtar. 34. Borxh. 36. I lëngshëm. 39. I mbushet mendja. 40. Nyje e pashquar e anglishtes. 41. Varg i madh kafshësh. 43. Djalosh shtatlartë, guximtar. 44. Laurel, "i hollit". 45. Tajgë pa teke. 46. Nada pa zanore. 47. Pohim i italianëve. 48. Burrë me trup të gjatë, por jo të hijshëm. 50. Kur i vë fjalës, dmth se flet me mend. 54. Markë makine koreane. 56. Kandarët. 58. Mund të jetë i Punës, i Popullit, Kombëtar. 59. Ndoja, aktore shqiptare. 61. Kot pa kokë. 62. Parafjalë e gjuhës angleze. 63. Kur ia shtin dikujt, dmth se e fut në grindje, e ngatërron. 64. I pabindur; i panënshtruar.

VERTIKALISHT

1. Frut i bardhë e i zi. 2. Shtojcë, pjesë plotësuese. 3. Rinia Komuniste. 4. Simpatik; tërheqës. 5. Kur i vë aty kufirin, dmth se nuk e lejon të hyjë në punët e tua; se i tregoi vendin. 6. Ndjenja e respektit. 7. Flori. 8. Trungu i trashë që përdoret në ndërtim. 9. Supet pa teke. 10. Të dashuroj, për italianët. 11. Viç 2-3 vjeçar. 12. E Madhe dhe e Vogël në Pogradec. 15. Mund të jetë i një veprë letrare. 16. Njëri i mjerë. 17. Kurat termale afër Elbasanit. 20. James, 007. 22. Grup Teatral. 25. Hetimet paraprake. 26. Shkruajti "Metamorfoza". 29. Qëllon që me një, të vrasësh dy zogj. 32. Kongo pa limite. 33. Jo rrallë. 35. E njëzëshme. 37. Ndajnë qytetin. 38. Georges Jacques, udhëheqës revolucionar francez. 39. Vegël muzikore. 42. Tërësi e vlerave morale të dikujt. 44. Teket në Sapada. 49. Skajor. 51. Letër në bnxhnoz. 52. Thuhet se po të jetë vere, është si vrap i gomarit. 53. Breg shkëmbor që zgjatet në det. 55. Ameba pa ma. 56. Lumi më i gjatë i Italisë. 57. Përemër pronor. 58. Nuk rri me barkun bosh. 60. Paçino i kinemasë.

HORIZONTALISHT: 1. MANI, 2. ANEKS, 3. RK, 4. ATRAK-
VERTIKALISHT: 1. MANI, 2. ANEKS, 3. RK, 4. ATRAK-
TIV, 5. THANA, 6. NDERIM, 7. AR, 8. TRAU, 9. UE, 10.
TIANO, 11. DEM, 12. PRESPA, 15. EKRAMIZIM, 16.
MUERAN, 17. LUXHAT, 20. BOND, 22. GT, 25. SON-
DASHET, 26. KARKA, 29. GUR, 32. ONG, 33. DEN-
DUR, 35. UNANIME, 37. LAJGJET, 38. DANTON, 39.
BAS, 42. NDER, 44. SPD, 49. ANOR, 51. AS, 52. SHI,
53. KEP, 55. AEB, 56. PO, 57. TI, 58. HA, 60. AL,
63. PISHAT, 64. REBELL,
HORIZONTALISHT: 1. MARATONA, 8. TUB, 11. DP-
13. ANKTH, 14. DRERE, 16. MILLER, 18. NE, 19.
RABE, 21. KA, 22. GJALME, 23. KLANOR, 24.
DM, 31. NONDA, 34. HUA, 36. FLUID, 39. BINDEIN, 40.
AN, 41. KARVAN, 43. AZGANA, 44. STAN, 45. AG, 46.
ND, 47. SI, 48. ZDAP, 50. JASTEK, 54. HUNDAL, 56.
PESHORRET, 58. HERO, 59. EMA, 61. OT, 62. NI, 63.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
16						17		18		19				
20				21			22			23			24	
25			26							27				
28					29			30				31	32	
33			34	35				36				37		38
39		40				41			42	43				
	44				45	46				47				
48				49				50						51
		52			53			54		55			56	
57	58				59							60	61	
										63				

HORIZONTALISHT

1. Veprimet e vështira që bën dikushi për të njohur aftësitë e tij. 7. Amvisat që kujdesen për punët e shtëpisë. 16. Gjykatës i një loje. 18. Miho pa limite. 19. Dashnorë. 20. Nani, regjisor. 21. Rrahje e parregullt e zemrës. 23. Lehu pa çifte. 24. Port i vogël. 25. Neta pa limite. 26. Heroi ynë kombëtar. 28. Shtet që bëntë pjesë në URSS. 29. I vogli i një shpendi. 30. Jetoj. 31. Çak pa mes. 33. Meli pa ei. 34. Graham i "Komedianët" (shqip). 36. Emri i djalit të Skënderbeut. 37. Shijaku, piktor. 39. Vend ku rrinin perënditë. 41. Rrëzohet; nuk e mbajnë këmbët. 42. Vendlindja e Sadam Hyseinit. 44. Që i shërben përhapjes së dijeve. 47. Gojore; me gojë. 48. Fjalë që mbyll të gjithë lutjet. 49. Sipas popullit, kur je një copë e tillë me dy sy, d.m.th. je i trashë. 50. Gjeti llampën magjike. 52. Republikë Demokratike. 53. Quhet ndryshe pasuria e patundshme. 55. OKB-ja në gjuhën angleze. 56. Tago pa çifte. 57. Kafshë e egër. 59. Míngi, këngëtar italian. 60. Thirrje. 62. Në mes të Jose dhe Ruiz, në emrin e një novelisti dhe kritik u spanjoll. 63. Teksti letrar i një opere.

VERTIKALISHT

1. Emër i një qyteti italian. 2. Sjellje rreth vetes. 3. Lumi i kozakëve. 4. Gjashta e romakëve. 5. Sulm. 6. Kur e bën me shumë, dmth se e bën me kujdes të madh. 8. Krunde. 9. Letrat që i dejtohen dikujt e përmbajnë një lajmërim, një njoftim. 10. Shkencë që merret me studimin e kafshëve e bimëve që i takojnë periudhave të tjera gjeologjike (GJ=G). 11. Janë Malta dhe Qipro. 12. Lloj druri. 13. Rossi Stewart i kinemasë italiane. 14. Umberto, shkrimtar italian. 15. Wilhelm, dramë e Gëtes. 17. Përtërin; i jep gjallëri. 22. TDG. 26. Froyd, babai i psikoanalizës. 27. Një vegël muzikore. 31. Çaplin, aktori. 32. Blerësit. 35. Rriparim pa iari. 36. Këmbëza e shkreppjes së armëve. 37. Mbaruar; afatsosur. 38. Përemër i gjuhës angleze. 40. Shqipëria në kohë të lashta. 41. Dialog; komunikim. 43. Më parë quhej Persi. 45. Arbeni i politikës. 46. Ikin; largohen. 48. Bolena, gruaja e Enrikut VI të Anglisë. 51. Tare në futbollin italian. 54. Përemër i gjuhës italiane. 58. Roma pa çifte. 59. Baba në disa dialekte. 61. Fije për të qepur.

VERTIKALISHT: 1. PALERMO, 2. RROTULLIM, 3.
OBI, 4. VI, 5. ATRAK, 6. TERREZI, 8. HINIE, 9.
THIRREJET, 10. PALEONTOLOGJI, 11. ISHULL, 12.
KLIENET, 35. RPM, 36. GISHTEZ, 37. SKADUAR,
38. IT, 40. LIRIA, 41. BISEDE, 43. IRAN, 45. IMA-
MI, 46. NISEN, 48. ANA, 51. IGLI, 54. IO, 58. RM,
59. AT, 61. PE,
HORIZONTALISHT: 1. MARATONA, 8. TUB, 11. DP-
13. ANKTH, 14. DRERE, 16. MILLER, 18. NE, 19.
RABE, 21. KA, 22. GJALME, 23. KLANOR, 24.
DM, 31. NONDA, 34. HUA, 36. FLUID, 39. BINDEIN, 40.
AN, 41. KARVAN, 43. AZGANA, 44. STAN, 45. AG, 46.
ND, 47. SI, 48. ZDAP, 50. JASTEK, 54. HUNDAL, 56.
PESHORRET, 58. HERO, 59. EMA, 61. OT, 62. NI, 63.
TINEZ, 63. LIBRETTI,
16. ARBITER, 18. HI, 19. ASHKE, 20. LOI, 21. AR-
ITMI, 23. LH, 24. MOL, 25. ET, 26. SKENDERBEU,
GRIN, 36. GJINI, 37. SALLI, 39. OLMAR, 41. BIE, 42.
TRKRI, 44. ILUMINIST, 47. ORALE, 48. AMINI, 49.
MISH, 50. ALDANI, 52. RD, 53. ASETI, 55. ONU,
56. TG, 57. ARI, 59. AMDEDO, 60. APEL, 62. MAR-

www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.



Stranieri in Italia



Dashi (21 mars - 20 prill)

Dashuria: Një telefonatë që nuk besojë se do të të mbërrinte, do të ta bëjë pa masë qejfin. Përpiku të mos jesh shumë i rrëmbyeshëm.

Puna: Kërshëria do të jetë në plan të parë e do të bësh ç'të të jetë e mundur për të dëgjuar një diskutim mes ca njerëzve që punojnë me ty. Shëndeti: Ke nevojë të hash fruta dhe perime.



Luani (23 korrik - 23 gusht)

Dashuria: Fantazia jote do të marrë flatra, e do të arrish të tërheqësh partnerin tënd ndër gjëra të bukura të reja.

Puna: Do të kesh mundësi të lehtësosh barrën e punëve të tua duke ia lënë të tjerëve gjërat që nuk arrin të përfundosh. Shëndeti: Mbaje qafën të mbuluar mirë.



Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)

Dashuria: Do të tregohesh shumë i/e ëmbël me partnerin, sepse do të kuptosh se po kalon momente të vështira në punë.

Puna: Rezultatet do të jenë më të larta sesa ato që pritje. Lavdërimet për profesionalitetin tënd nuk do të të mungojnë. Shëndeti: Kujdes shpinën.



Demi (21 prill - 20 maj)

Dashuria: Meqë mendon se i dashuri apo e dashura jote të lënë pas dore, do të përpiqesh të sillesh ndryshe, në mënyrë që ata të përqëndrojnë vëmendjen e tyre tek ti.

Puna: Mundi i punës së madhe do të të jetë i shpërblyer, e gjithçka do të jetë në favorin tënd. Shëndeti: mbulohesh mirë e ruaj të ftohtit.



Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)

Dashuria: Nuk duhet të bësh komente të gjata, sepse në këtë mënyrë do të lëndosh ndjeshmërinë e personit që do.

Puna: Ka mundësi që njohja e njerëzve të rëndësishëm do të të ndihmojë për të ardhmen tënde profesionale. Shëndeti: Nuk është e thënë se s' do të të zërë gripi.



Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)

Dashuria: Do të marrësh një lajm të këndshëm nga një njeriu të cilin s'e dëgjoje prej kohësh, e të cilin do ta takosh.

Puna: Do të jesh shumë i/e prirur t'ia hapësh zemrën një kolegu/eje... por kujdes, muret kanë veshë! Shëndeti: Mos e tepro me pijet që kanë përqindje të lartë alkoli.



Binjakët (21 maj - 21 qershor)

Dashuria: Do të njohësh dikë që mund të bëhet shumë i rëndësishëm për ndjesitë e tua të përditshme.

Puna: Edhe nëse gjërat nuk do të rrjedhin ashtu siç e prisje, mos u pushtu nga ankthi.

Shëndeti: Kujdesu për shëndetin e këmbëve.



Peshorja (23 shtator - 22 tetor)

Dashuria: Mos i trego problemet e tua personave të cilët nuk i njeh mirë, sepse sa të hapësh e të mbyllesh sytë, të gjithë do i marrin vesh ata.

Puna: Falë këshillave të një miku do të kesh mundësi të përmirësosh të figurën tënde profesionale. Shëndeti: Ke nevojë të pushosh më shumë.



Ujori (21 janar - 19 shkurt)

Dashuria: Do të bësh një takim intrigues, që do të nxjerrë në pah aftësitë e tua ngashnjeyse.

Puna: Do të vendosësh që mos ta ngarkosh vehten shumë me punë, e do të organizohesh për të zgjidhur ato më urgjentët. Shëndeti: Pi ca çaj me bimë mjekësore, sepse do të të bëjë mirë.



Gaforja (22 qershor - 22 korrik)

Dashuria: Pozitiviteti do të tërheqë pas partnerin tënd, që do i përngjitet të gjitha iniciativave të tua.

Puna: Gjithçka po shkon përsëmbari, e më në fund do të kesh mundësi të ndjehesh pak më i çliruar shpirtërisht dhe të përmirësosh të ardhurat e tua. Shëndeti: Të duhet të hash me kujdes.



Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)

Dashuria: Gjendja jote shpirtërore do të jetë vazhdimisht e ndryshueshme për shkak të një vendimi të partnerit, vendim ky që s' do të të pëlqejë dhe aq shumë.

Puna: Mos ki shumë keqardhje për gjërat që kanë kaluar, por përvish mëngët, që të gjesh qetësinë e humbur të dikurshme. Shëndeti: Merru pak me sportin.



Peshqit (20 shkurt - 20 mars)

Dashuria: Shkurti do të jetë shumë pozitiv por njohje të reja, sidomos, ditët e fundit të tij, kur takime interesante do të bëjnë të ndihesh me humor të mirë.

Puna: Me ndihmën e sinqertë të ndonjë kolegu do të çash përpara pa probleme. Shëndeti: Forma fizike ka rëndësinë e saj, ndaj mos e lër pas dore.

CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA



TANI! KOMISIONE TË REJA NGA ITALIA!

Të afërmit tuaj mund të dërgojnë tani
deri në 100 Euro vetëm me **7 Euro***!

Komisionet janë të vlefshme për dërgesa në Shqipëri nga Lombardia, Emilia Romagna, Piemonte, Liguria, Valle d'Aosta, Trentino Alto Adige, Veneto dhe Friuli Venezia Giulia.

**WESTERN
UNION** | |[®]

Përveç komisionit të transfertës Western Union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhën vendase. Komisionet janë të vlefshme për një periudhë të pa përcaktuar duke filluar nga 28 Janar 2008.

**Transfertë parash - e shpejtë, e besueshme.
Për më shumë informacion: +355 4 23 49 79**